Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (51). KORRIK 2010. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP SH.P.K.
PROJEKTIM - ZBATIM
koha kalon, cilësia mbetet
Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

KUMTESË

Nënë Tereza: Një jetë në shërbim të njerëzimit

Nga: **DR. GËZIM ALPION** - FAQE 11

EMIGRACION

Brenga dhe drita që i vjen Idriz Bucit

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 13

KUJTESË

Përurohet busti i atdhetarit Mersim Dema

Nga: **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 12

“BIBOLLASIT”, një toponim alegorik i Shqipërisë postkomuniste

U prezantua më 21 korrik, mjediset e librarisë “E për7shme” në Tiranë, romani “Bibollasit” i autorit Ramiz Gjini.

I njohur dhe i konfirmuar prej kohësh si një ndër mjeshtrit e padiskutueshëm të prozës sonë të shkurtër bashkëkohore (për çka flet dhe interesimi i përkthyesve të huaj, me botimin e përmbledhjes së zgjedhur me tregime në rumanisht, “Atdheu prej dëbore”, nga përkthyesi i njohur Marius Dobresku), Ramiz Gjini ka kaluar në lëvrimin e prozës së gjatë.

Romani “Bibollasit” përbën dylogjinë satirike të “Bibollit”, një toponim alegorik i Shqipërisë postkomuniste dhe është vazhdim i romanit të mëparshëm “Rrëketë”. Situatat dhe skenat e shumta komike në romanin “Bibollasit” përshkohen nga humori i zi, absurd, plot elemente fantastike e demonologjike, duke krijuar një strukturë shumështresore dinamike të një rrëfimi të gjallë e sugjestionues. Është një roman që përfshin universalet absurde, nonsensin e përditshmërisë, kaosin psikologjik të një shoqërie të dalë nga diktatura. Afresku rrëfimor të rrëmben me një galeri tipash naivë, megalomanë, mashtrues, simulakër e psikopatë, por që secili bart të vërtetën e tij. Përmes këtij vëllimi, autori na zbulon diavoliadën shqiptare të kaosit individual e shoqëror.

Edhe pse personazhet janë thuajse të gjithë negativë, antiepikë e kontradiktorë, këta antiheronj janë përshkruar me dhimbje, përvuajtje e dashuri, një karakteristikë e hershme që i dallon të gjitha krijimet e Ramiz Gjinit.

Romani “Bibollasit” i Ramiz Gjinit, i botuar nga “Botimet M&B” dhe vjen pas vëllimeve me tregime “Dush varrezash”, “Këpucët e të tjerëve mbi trotuar”, “Atdheu prej dëbore”, “Mendjet e njerëzve”, “Rrëfime në hije”, “Posta që sjell era” dhe romanin “Rrëketë”.

Në prezantimin librit folën shkrimtarë, gazetarë dhe miq të Ramizit, të cilët e vlerësuan romanin e ri, si një kontribut në letërsinë moderne shqiptare.

Për lexuesit, po sjellim disa nga diskutimet e pjesmarrësve.




Foto. ZAYA

SPECIALE NGA PREZANTIMI I LIBRIT NE FAQET 3,8,9,10



Festa e Korabit

REPORTAZH NË FAQEN 6

OPINION

“Djemtë e Radomirës”

Nga: **JAHE SELMAN** - FAQE 7

KRITIKË LETRARE

Djavoliada bashkëkohore e Ramiz Gjinit

Nga: **AGRON TUFA** - FAQE 3,10

VLERËSIME

- SHINASI RAMA: **“Bibollasit”, një traktat politik dhe social**
- XHAFER MARTINI: **“Bibollasit”, një roman i ri që i mungon letërsisë shqiptare**
- SAMI MILLOSHI: **Një realitet shqiptar i epokës sonë**
- ANDON ANDONI: **Një roman që do trondisë letërsinë shqipe**

cyan magenta yellow black 1

Rruga Arbërit nr. 51
veprimtari

Konsulli FIRERA : Herën tjetër do të kthehem në Shqipëri me sipërmarrës industrialë, të cilët shfaqin interes të vërtetë për këtë zone

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (51). 1 - 31 Korrik 2010

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, Xhafer Martini, Vesel Hoxha, Isa Halilaj, Selman Meziu, Xhelal Roçi, Abdurahim Ashiku, Murat Koltraka, Agim Pepa, , Dukagjin Hata, etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës. Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Agron TUFA
Gëzim ALPION
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Xhafer MARTINI
Sami MILLOSHI
Shinasi RAMA
Andon ANDONI
Jahe SELMANI
Beqir SINA
Selman MEZIU
Saimir SHATKU
Hysen LIKDISHA
Hasan PASHA
Mevlud BUCI
Ymer KETA
Aqif KARAJ
Myhyr Hoxha, etj.

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

KRYETARI DR. BOROVA DHE KONSULLI FIRERA

"Dibra, një rajon ekonomik tepër i sigurtë"

Kryetari i Shoqatës Bashkësia Dibrane, Dr. Faruk BOROVA, ditën e premte në dt. 23 Korrik 2010, priti në një takim kortezial në Tiranë, Konsullin e Torinos (Rajoni i Piemontes-Itali) Dr. Giovanni FIRERA. Në këtë takim miqësor dhe dashamirës, Dr. Faruk Borova, i bëri një rezyme konsullit Firera mbi veprimtarisë e shoqatës Bashkësia Dibrane, si dhe historikun e krijimit të saj. E iniciuar nga një grup intelektualësh Dibrane të cilët jetonin në Tiranë, u themeluar kjo shoqatë me karakter kulturor dhe patriotik, theksoi Z. Borova. Qëllimi dhe motivet e kësaj shoqata janë shpirti dhe zemra tek të parët tanë, si dhe tek qyteti i Dibrës së Madhe. Eshtë detyrë e secilit prej nesh që të ndihet krenar, dhe i motivuar për vendlindjen e tij, e të japi qoftë dhe një kontribut modest për zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të saj. Ndërsa konsulli Firera, i shprehu dëshirën dhe vullnetin e tij të plotë për të bashkëpunuar seriozisht me kryetarin Borova, si dhe me shoqatën Bashkësia Dibrane. "Ju keni një margaritar tepër të çmuar, që Zoti e ka paisur me të gjitha cilësitë natyrore".

Pjesa e verilindjes së Shqipërisë, e sidomos Dibra, ka nevojë për investime konkrete dhe hapje të vendeve të reja pune. Konsulli Firera, mori përsipër lobimin e tij, duke u lidhur me sipërmarrës Torines, e Piemontez, të cilët të bëjnë të mundur thithjen e investimeve konkrete për zonën e Dibrës. Z. Firera, theksoi se në Rajonin e Piemontes, ekziston një komunitet shqiptar por dhe dibranë të cilët me punën e tyre të ndershme janë bërë sipërmarrës dhe bismesmen të suksesshëm, të cilët kanë aftësi të investojnë për projektet tuaja. Kryetari Borova e njohu Konsullin e Torinos, dhe me investimet konkrete nga ana e qeverisë Shqiptare. Kështu theksoi Z. Borova, një fond i tërë nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, është vënë në dispozicion nga ana e qeverisë, për ndërtimin e një vepre kolosale për kombin tonë, "Rrugën e Arbërit". Me realizimin e kësaj rruge kombëtare Tirana afrohet më shumë se kurrë me Dibrën e Madhe dhe me trevat e tjera shqipfolëse të Maqedonisë. Konsulli i Torinos, Z. Firera, ndër të tjera foli dhe mbi impementimin sa më shpejt të projekteve dhe iniciativave me karakter ekonomiko-social që do ti propozohen nga ana e shoqatës Bashkësia Dibrane, si dhe nga ekspertët e saj. Do ta kthejmë Dibrën dhe zonat e saj përreth në një rajon të fuqishmëm ekonomik dhe imprenditorial, theksoi konsulli Firera. Nga ana tjetër theksoi në këtë diskutim Kryetari i Shoqatës, Z. Borova se ndërtimi me procedura të përshpejtuara i "Rrugës së Arbërit", do të potencoi dhe projekte mjaft ambicioze dhe në kuadrin universitar dhe kulturor, duke ditur faktin se banorët e këtyre zonave janë njerëz arsimdashës dhe tepër të motivuar për dije dhe kultur shkencore. Herën tjetër do të kthehem në Shqipëri theksoi Konsulli Firera, me sipërmarrës industrialë, të cilët shfaqin interes të vërtetë për këtë zone. Takimi u mbyll me shtrëngimin e duarve mes Kryetarit të Shoqatës dhe Konsullit të Torinos, si dhe duke vendosur dimensione të reja bashkëpunuese.



Në fotografi: Shtrëngim duarsh mes Kryetarit të Shoqatës "Bashkësia Dibrane" Dr. Faruk Borova dhe Konsullit të Torinos (Rajoni i Piemontes-Itali) Dr. Giovanni Firera.

"Në Rajonin e Piemontes, ekziston një komunitet shqiptarë, por dhe dibranë të cilët me punën e tyre të ndershme janë bërë sipërmarrës dhe bismesmen të suksesshëm, të cilët kanë aftësi të investojnë për projektet tuaja"

SAIMIR SHATKU, MA.

HUMANIZMI I VËLLEZËRVE KOLARI NGA DIBRA

Dhuruan EKO prej 30 mijë dollarësh

Në Spitalin e Përgjithshëm në Dibër, në praninë e stafit udhëheqës dhe mjekëve e specialistëve që punojnë në këtë institucion shëndetësor, vëllezërit Kolari, Besniku, Sabriu, Ibrahimi dhe Remziu, të cilët jetojnë dhe punojnë në SHBA, dhuruan një aparaturë EHO tredimensionale për diagnostifikimin e sëmundjeve të stomakut, zemrës dhe fytit me vlerë prej 30 mijë dollarëve.

Ibrahim Kolari, biznesmeni dibrano amerikan, njëherit edhe kryetari i Shoqatës Atdhetare Dibrane, duke e dorëzuar këtë aparaturë, theksoi se, "ju përshëndes të gjithëve për punën me përkushtim dhe devotshëmri që po e kryeni në të mirë të dibranëve. Para tre muajve në takimin që pata me Dr.spc. Baki Alili, drejtorin e Spitalit të Përgjithshëm dhe me Dr. spc. Ylber Kokale, drejtorin e Shtëpisë së Shëndetit, ata shfaqën shqetësimin e tyre për mungesën e një aparature të këtillë, e cila do të mundësonte diagnostifikimin e shumë sëmundjeve. Unë me tu kthyer në SHBA bisedova për këtë punë me vëllezërit e mij Besnikun, Sabriun, dhe Remziun. Ata menjëherë shfaqën gatishmërinë që ta blejmë e ta dhurojmë në Dibër një aparaturë të këtillë. Dr. Bahri Ceku ulqinak, mjeku amë i shumë dibranëve në SHBA, të cilin shkova ta konsultoj për llojin e aparaturës që duhet ta blenim, jo vetëm që më ndihmoi në zgjedhjen profesionale, por gjatë blerjes së aparaturës pagoi 5 mijë dollarë të tija si ndihmë dibranëve. . Kjo aparaturë është lëvizëse dhe në rast të ndonjë difekti eventual, lehtë mund të dërgohet për riparim në SHBA, Greqi ose Gjermani. Kjo aparaturë do tu mundësojë dibranëve që për ekzaminime shëndetësore të mos udhëtojnë në Shkup, Tetovë, Ohër apo Manastir. Këtë aparaurë do ta shfrytëzojnë të gjithë ata që do të vizitohen në spitalin e Dibrës.


Dr. spc. Baki Alili, në emrin e tij dhe në emër të punonjësve të këtij spitali, falenderoi nga zemra vëllezërit Kolari dhe mjekun ulqinak Dr.Bahri Ceka, për këtë dhuratë të çmuar për mjekësinë dibrane. Me fjalë miradie u shprehën edhe Dr.spc. Lulzim Mela dhe Dr. spc. Ylber Kokale, duke apeluar se kjo duhet të shërbejë si shembull i mirë që në këtë drejtim të angazhonen edhe biznesmenët e tjerë nga mërgata dibrane.



Rexhep TORTE

kritikë letrare

Djavoliada bashkëkohore e Ramiz Gjinit



Ramiz Gjini. Foto. Zaya

Mbi romanin "Bibollasit" të Ramiz Gjinit, 407 f, Botimet "M&B", Tiranë 2010

Nga: **AGRON TUFA**

I

Pas pesë vëllimeve me tregime dhe romanit të parë "Rrëketë", i konfirmuar si një ndër mjeshtrat e prozës së sotme bashkëkohore, shkrimtari Ramiz Gjini vjen këtë herë me romanin e dytë "Bibollasit", i cili është të vazhdim në frymën e romanit të parë, apo më saktë, përbën dylogjinë satirike mbi Bibollin.

Bibolli është një topos letrar alegorik i sajuar prej autorit, në akord me traditat aluduese të shumë shkrimtarëve që vendosin koordinatat e atdheut të tyre letrar eksperimental, sikundërse, fjala vjen, Yaknapatofa e Folknerit.

Situatat dhe skenat e shumta komike në romanin "Bibollasit" përshkohen nga humori i zi, absurd, plot elemente fantastike e demonologjike, duke krijuar një strukturë shumështresore dinamike të një rrëfimi të gjallë e sugjestionues. Është një roman që përfshin universalet absurde, nonsensin e përditshmërisë, kaosin psikologjik të një shoqërie të dalë nga diktatura. Afreska rrëfimore të rrëmbën me një galeri tipash naivë, megallomanë, mashtrues, simulakër e psikopatë, por që secili bart të vërtetën e tij. Para nesh kemi një penë mjeshtërore, një rrëfimtar të lindur, që zbulon nëprmjet humorit të zymtë, plot poezi, diavoliadën shqiptare të kaosit individual e shoqëror. Edhe pse personazhet janë thuajse të gjithë negativë, antiepikë e kontradiktorë, këta antiheronj janë përshkruar me dhimbje, përvujtni e dashuri, një karakteristikë e hershme që i dallon të gjitha krijimet e Ramiz Gjinit.

Bibolli i Ramiz Gjinit është një kategori kohë-hapësinore marrëzish saturnale, ngërdheshëse, një bashkësi që ka dalë nga ploja diktatoriale, një pluhurnajë njerëzore psikopatologjike, e cila me thërmijat e rrënojave të diktaturës, kërkon të ngjizë planetin e vet, ekzistencën e vet autentike, të disiplinojë kaosin individual dhe shoqëror në një farë rendi e regulli. Dhe pikërisht në këtë rrekje hapet paradoksi i madh i greminës, që nxin e thëthin konstruktet mendore, shpirtërore e utopike të protagonistëve të romanit, pa ia dalë dot t'i japin trajtë e formë kaosit në kozmos. Në këtë kuptim sarkazma e romanit fikson dështimin spektakolar, bëhet apoteoza e dështimit mu përmidis euforisë, shpirtit luftarak që ushqehet me sllogane dhe mbështetet mbi stërkëmbsha. Egoizmi i sëmurë, përpjekjet sizifiane të protagonistëve krijojnë veçse një shtijani, simulakrum, fiktivitet shoqëror, duke përfunduar në një bufonadë patësosur. Duket se qyteti që shtrihet poshtë "malit të Hidrës me shtatë krenja", më parë se nën hijen e një demoni mitologjik, gjendet në grackën e një mallkimi që i vjen nga e shkuara, prej së cilës çlirohen impulse fatale, siç ndodh rëndom me shoqëritë e keqvendosura, që hedhin shtat të zi në ekzistencën e vet. Duket se vështrimi nga "mali i Hidrës me shtatë krenjë" është i vetmi horizont perspektiv që mbyllet kërcënueshëm për çdo ardhmëri shpresëdhënëse.

Ka një personazh konstant që shoqëron aktet dhe motivimet e bibollasve, një personazh që shkakton çrregullimet, anarkinë, perversitetet e përditshmërisë, që është kryeshkaku, neuroza, pengu që s'le askënd të qetë dhe që në roman dhe ndikon si sëmundje lënguese pa shërim. Ky personazh është *mërzia e thellë*. Ajo modulon formën e monologut, arsyetimit, bëhet shkak depresionesh dhe befas shpërthen në suicide qesharake m'u përmidis entuziazmit të heronjve. Mërzia e thellë është një brengë e trashëguar në kodin psikogjenetik të heronjve të Bibollit. Ajo ngre krye dhe teptis në minuta fatale në fatin e heronjve, si diçka e dhënë, së cilës nuk i shmangesh dot. Madje edhe marrëzitë, aventurat e trasha, sharlatanizmat, batakçillëqet – të gjitha bëmat qesharake e të turpshme të protagonistëve, sprapsen para pllakosjes së *mërzisë së thellë*: gazi shuhet dhe në vend të ngërdheshjes, vërshon proza e zymtë, analitike e meditative me pikëpyetjet e zeza që nxijnë brenda kokës së heronjve. Vjen pikërisht ai çast kritik zbulese kur personazhi qendror prek natyrën iluzore të gjithçkaje ekzistuese: bota shndërrohet në ëndërr, vegulli, fanitje dhe s'ka asgjë të qëndrueshma përveç ndoca aludimeve të tretura në hamendje. Hamendje janë bëmat, fjalët, gjestet, veprimet, opinjonet; hamendje është krejt realiteti dhe vetë ekzistenca tkurret në një hamendje.

Çfarë përfaqëson letrarisht Bibolli dhe bibollasit e Ramiz Gjinit? Mua më duket se kemi të bëjmë me farsën e një utopie ideologjike shoqërore. Në thelb parodia e romanit rrok çarjen fundamentale midis ideologjisë sllloganore të korrupsionit dhe praktikave të neveritshme për ta mishëruar realisht atë. Njeriu si më parë është po ajo krijesë egoiste e ideologjizuar nën diktaturë, e cila ka përshtatur në mënyrë politkorrekte një ideologji tjetër (të demokracisë dhe lirisë), e cila është po aq shtypëse dhe e hidhur sa e para. E në këtë kuptimi kjo vepër e Ramiz Gjinit është një model, ndonëse përmes humorit të zi, i romanit antiutopik apo utopisë së keqe.

II

Fijet e bëmave (çka përbën dhe shtratin e historisë së romanit "Bibollasit"), shtjellen rreth protagonistit qëndror të rrëfimit, Zav Tarrotës, një hero arketipal i "popullit të madh", i pashkollë, i zgjuar e dinak, por tepër i sinqertë në heroikën e tij të përditshme për mbijetesë familjare. Atij i duhet të përshtatet që të fitojë "bukën e përditshme" për familjen e tij të madhe, andaj, pa ndonjë profesion të qëndrueshëm, ai bën çfarë i vjen ndoresh në kushtet e "ligjit të xhunglës". Për të ideologjitë dhe bindjet politike partiake nuk kanë vlerë, nëse nuk i shfrytëzon për të siguruar ekzistencën e familjes së vet halleshumë. Prandaj zanatet dhe punët e tij janë aq të larmishme, sikundër është spontane vetë përditshmëria konjukturale e Bibollit. Zavi lufton me armët e tij, duke u shtyrë në "rrymë" nga njëri interval në tjetrin, nga njëra situatë në tjetrën, si një qenie itenerare. Logjika e kësaj përditshmërie është po aq absurde, sa edhe zanati që ushtron ai në faqet e romanit: zejen e kapjes së mizave dhe buburrecëve nëpër shtëpitë private. Maksimumi i perspektivës së kësaj pune absurde, është shpresa e Zav Tarrotës mos këtë punë, me ndërhyrje e miqësi, e zhvendos nga sfera private në atë shtetërore. Një status i tillë do ta bënte Zavin të ndjehej më legjitim. Më saktë kemi të bëjmë me një metaforizim të nonsensit, sipas idiomës popullore "me vra miza". Kjo llojë pune e shpie Zavin nëpër shtëpi të ndryshme të qytetit, nëpër personalitetet e shtetit dhe nëpërmjet këtij truku narrativ, përftojmë dhe një guidë njohëse me personat që përbëjnë "ajkën" e Bibollit. Rrëfimet ndjekin njëri-tjetrin duke u dërdhur së bashku në një rrjedhë dinamike, derisa ky hero i "heshtur", pasi ka shitur "enigmat e veta në trajtë pikëpyetjesh të zeza", i zbrazët e tëhuajësuar, dehet *për shkak të mërzisë së thellë*, bie në një gropë me beton të freskët në mes të sheshit dhe mbetet ashtu të nesërmen, i betonuar për së gjalli, përmendore e gjallë, mu në ditën kur në shesh çelet panairi i ushqimeve.

Pikërisht atëherë ky personazh i pavënëre, bëhet çështje publike dhe shteërore. Rreth tij grumbullohen sehirtarët, elita politike dhe shoqërore e qytetit; të gjithë kërkojnë një zgjidhje, sikundërse gjithkush kërkon të nxjerrë përfitime politike apo projekte paradoksale biznesi. Parimi "panair" rreth heroit të betonuar për së gjalli deri në gju, dendësohet me figura të reja, duke e shpërhapur rrëfimin në rrathë koncentrikë, në spirale nivelesh të reja, duke e zgjeruar vazhdimisht tablonë. Shteti, policia, feja, artistët e kundrojnë spektaklin tragjikomik, duke vënë në lëvizje mekanizmat e "shpëtimit", që janë veçse përrënj të një retorike shterpë, të cilat ngadalësohen nga teka e një bosi të huaj të një fondacioni bamirës (njëkohësisht dhe një lloj çiçikovi modern, që është marrë me blerjen e kufomave) – atij i ka shkrepur ta filmojë ngjarjen nga një këndvështrim filozofik, për t'ia shitur një kanali të huaj. Me gjithë masat e marra në shkallë shtetrore, Heroin nuk e çlirojn shteti nga betoni (edhe këtu - një zgjerim ironik i idiomës frazeologjike mbi shtetin, i cili "nuk nxjerr dot qimen nga qulli"), por vetëm ndërhyrja konkrete e të nipit. Heroi kthehet në shtëpi i shfytyruar dhe i neveritur nga marrëzia kolektive, për të ndjekur i shtangur e pa fjalë spektaklin vetshkatërrues të bibollasve. Raporti i njeriut me shtetin, ndonëse në rrëfim kemi një prani të dendar e sunduese të të gjitha formave të mundshme të prezencës së shtetit. Mbetet raporti i një shprese të hedhur dëm, i një pritjeje të zbrazët, pa dalëzotës, i braktisur në një botë kërcënuese, jetime. Pikërisht jetimësia është ndjenja zotëruese në fatet individuale, por vini re, autori përmes paraqitjes së bëmave dhe qëllimeve të tyre, na e jep të gjallë kapërthimin e gjindjes, e cila përpiqet t'i zërë frymën njëri-tjetrit, duke hapur një gropë të madhe për vete dhe të tjerët. Ata nuk janë veçse një turrmë pa ndjenjën e perspektivës, një makth i verbër që rrokulliset drejt greminës. Dhe ky qëndrim kritik i autorit, na paraqet larg formave pseudohumaniste, se nuk mund të ketë shpresë në popull, pasi ai është një koncept amalgamë i shume heterogjene konfuzionesh. Një popull pa ndërgjegjen e elitës, është trup shumëgjymtyrësh pa kokë, pra, turrmë.

III

Romani "Bibollasit" tipologjikisht i përket asaj paradigme të veprës satirike, që origjinën e saj e nis me stërgjyshen e gjinisë së romanit "Gargantua dhe Patagryeli" të Rabëlesë, mandej me "Don Kishotin" e Servantesit, "Shpirtra të vdekur" të Gogolit dhe më vonë, me "Shvejkun" e Hashekut. Pra formalisht romani i Ramiz Gjinit është brenda një tradite klasike shekullore në formën dhe tipin e të qeshurit brenda peisazhit tradicional të kulturave gaztore popullore të Europës. Krahasimi, vetëkuptohet, ka të bëjë me traditën e zhanrit. Në kulturën tonë letrare, nëse lëmë mënjanë minuset ideologjike, e kanë praktikuar Qamil Buxheli ("Nën hijen e Dordolecëve", "Kariera e zotit Maksut"), Kolë Jakova (Fshati midis ujërave"), Dritëro Agolli ("Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", "Arka e djallit") deri tek Virion Graçi ("Shpata e ndryshkur", "Bijtë e zotit majmun"). Nga pikëpamja jashtëformale e të qeshurës, sigurisht, romani i Ramiz Gjinit, përfshij dhe paraardhësin e tij, romanin "Rrëketë", nuk hyn në marrëdhënie krahasimore me autorët e përmendur, por shënon një stad të një ironie në letrat shqipe, e kjo është cilësia e të qeshurit me pafuqinë, sepse ironia është nëna e pafuqisë për ta ndryshuar rendin e gjërave.

(Vijon në faqen 10)

Nga gjithë kjo diavoliadë që parakalon nëpër 407 faqe të romanit, ia vlen, edhe pse me humor, të mbrohesh nga energjia gjuhësore e botës së krijuar, nga kjo "bombë" artistike në miniaturë. Dhe sigurisht, edhe lexuesi do ta miratojë heshturazi me kokë, të vetmen bindje të padiskutueshme të engjëllit Azrail.

Nuk ka asnjë dokument historik që mund të dëshmojë se shqiptarët kanë okupuar qoftë edhe një metër të tërritorit të huaj. Këto janë të vërtetat për tua mbyllur gojën Serbisë e Rusisë dhe për tua hapur sytë atyre shteteve që u besojnë atyre.

Serbia e vogël në Kosovën e madhe



Nga **REXHEP TORTE**

Dinakëria dhe këmbëngulësia e diplomacisë së Serbisë e mbështetur nga ajo e Rusisë, me gënjeshtra dhe opcione nga më të ndryshmet janë duke e mbajtur zgjuar opinionin e brendshëm e atë ndërkombëtar lidhur me shtetin e ri të Kosovës. Njësitë paralele serbe në veri të Mitrovicës, protestat serbe të qershorit kundër hapjes së Zyrës Civile në Mitrovicë dhe shpërthimi i një granate që shkatoi një të vdekur e disa të plagosur, atentati para shtëpisë së tij në Mitrovicë ndaj Petar Miletiq, deputetit serb në parlamentin e Kosovës, Sesioni i jashtëzakonshëm i Këshillit të Sigurimit të OKB, më 6 qershor me kërkesë të Serbisë ku Boris Tadiq duke fajësuar Kosovën pësoi debakël pasi të gjithë e kuptuan se trazirat në veri dirigjohen nga Beogradi, dhe opsioni i fundit i lansuar nga Serbia për shkëmbim territoresh janë lojëra tepër të rrezikshme. A do t'i bëjë ballë diplomacia e re e Kosovës e mbështetur nga ajo e Shqipërisë këtij uragani serbo rus, do ta tregojë koha, por që nëvojitet një impenjim i fuqishëm, kjo s'do mend.

Kanë kaluar më shumë se dhjetë vite nga çlirimi i Kosovës nga pushtimi serb dhe dy vite nga shpallja e Shtetit të Kosovës të cilin gjer tani e kanë njohur 69 shtete, por ende nuk mund të largohet mjegulla e zezë nga Mitrovica dhe veriu i Kosovës, por edhe nga viset tjera të banuara me popullatë serbe, përkundër standardeve favorizuese më të avancuara për pakicat që s'i gjen askund në botë. Kalimi i serbëve ditë më parë nëpër vendkalimet kufitare të Kosovës pa respektuar rregullat policore e doganore, për të festuar ditën e vidovdanit në Bezistan dhe fjalimet për mosrespektimin e pavarësisë së Kosovës, dëshmuan edhe njëherë politikën okupuese të Beogradit. Kjo tregon se përkundër të vërtetës që është në anën e shqiptarëve, Kosova dhe blloku shqiptar duhet të jenë më energjik në pasqyrimin sistematik të çështjes së Kosovës. Kur shohim se me sa të pavërteta të turpshme Serbia dhe Rusia mundohen t'i nxjerrin nëpërkëmbëza shtetit të Kosovës, atëherë shihet qartë se sa duhet punuar ndërkombëtarisht për të treguar se si Serbia e vogël është futur në Kosovën e madhe.

Të shumta janë argumentet e Kosovës për të zezat, mizoritë dhe tmerret gjenocidale që serbët i kanë bërë ndaj popullit shqiptar, siç janë gjenocidet e viteve 1878, 1912, 1944 dhe 1999.

Të dhënat historike të pakontestueshme flasin qartë se Serbia ka qenë shtet në miniaturë si sanxhak i Beogradit, dhe se zgjërimi i saj është bërë gjithnjë nëpërmjet okupimeve të trojeve të huaja me vrasje e djegie, e më së shumti të trojeve shqiptare. Këto të dhëna historike dëshmohen edhe nëpërmjet një Faksimili të hartës së Enciklopedisë Ruse të vitit 1817, ku shihen qartë kufijtë realë të Serbisë në periudhën e viteve 1804, 1810, 1812, 1815, 1820, 1867 që janë shënuar në brendinë e kësaj harte. Kufijtë e sotëm të Serbisë ku përfshihet edhe Kosova, janë arritur vetëm nëpërmjet ekspeditave të përgjakshme serbe ndaj shqiptarëve. Në fshatin S... të Kosovës jeton një nënë shqiptare, si edhe mijëra nëna tjera shqiptare zemërplagosura, shpirti i të cilës do të mbetet gjithnjë i trishtuar. Jo pse në luftën e padrejtë që imponuan serbët në Kosovë, ia vranë burrin, djalin, ia përdhunuan para syve vajzën e re, por i bënë edhe gjëmën më të madhe që s'do ta kishte bë as soji i bishave më të tërbuara. I nxorrën me hanxhar syçkat e djaloshit tre vjeçar dhe ashtu të përgjakura e të ngrohta e detyruan me forcë që t'i gëlltisë. Këtë ia bënë serbët nënës së urtë e të ndershme shqiptare, si edhe mijëra nënave tjera, të cilat gjithnjë patën në zemër nderin, bujarinë e fisnikërinë, e të cilat asnjëherë nuk dijtën as të fyejnë e as të ngucin kend. Hordhitë ushtarake, policore dhe paramilitare, dogjën e vranë, prenë koka fëmijësh dhe përdhunuan mijëra vajza shqiptare dhe detyruan të shpërngulen më shumë se një milion e gjysëm shqiptarë nga Kosova.

Kemi apeluar disa herë , por pa sukses, që Libri "Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë" i autores Luljeta Selimi të përkthehet e tu dërgohet Ban Ki Munit, diplomatëve në OKB dhe tërë lidershipit botëror. Secili që do ta lexonte këtë libër, do të rrënqethej se çfarë krimesh kanë bërë serbët edhe ndaj femrave shqiptare në Kosovë, dhe me siguri do të kuptonin e bindeshin të jenë në anën e shtetit të ri të Kosovës, në anën e të vërtetës.

Ja disa grimca nga ky libër. " Ma pushkatuan nënën e vëllanë, kurse mua më dhunuan dhe trupin tim e masakruan për së gjalli me cigare". Një nga mjeket deklaron se,"Vajzës së dhunuar i ishte shqyer mitra dhe se në organet gjenitale i kishn futur rërë, këmbët i kishte të gërvishtura dhe mes dy gjinjëve me majën e thikës kishte të vizatuar kryqin serb". Ose rrëfimet e tjera," Fëmijët vajtonin mbi trupin e përgjakur të babait të tyre të vrarë, e mua më çnderonin vetëm disa metra larg tij"," Pasi ma vranë djalin, mua më çnderuan disa ditë me radhë", "Djalit dy vjeçar ia prenë veshin dhe tre gishtërinj, e pastaj më dhunuan", "Më dhunuan para syve të nënës", "Më dhunuan e ma prenë gjirin", "Cigaren e ndezur e fiki në gjinjtë e mi", "Me thikë shkruan fjalë mbi trupin tim, "Më detyronin t'i shiqoja femrat që po i dhunonin me radhë", "Pasi më dhunuan, m'i hoqën thonjtë me dana", "Motrën e mbytën me kundak të pushkës", "14 vjeçarja u dhunua në borë", "Pasi e dhunuan 13-vjeçaren e hudhën në pus", "Më çnderuan para syve të babait dhe nënës", "Në muajin e tetë të shtatzanisë më përdhunoi para vjehrës dhe burrit, e pastaj më goditi në gjoks e në bark dhe linda fëminë e vdekur", " Më dhunuan dhe në krah ma vizatuan kryqin serb", "Pasi i çnderuan tri vajza, ua prenë organet gjenitale"....

Këto janë disa sekuenca të mizorive serbe gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë, duke mos harruar vrasjet e shumta, djegiet, varrezat masive dhe dy mijë të zhdukurit, për të kuptuar më mirë se çfarë mizorishë kanë kryer ata në gjenocidet më të hershme ndaj shqiptarëve. Kështu është zgjeruar Serbia në dëm të territoreve shqiptare, e tani me paturpësinë më të madhe kërkon shkëmbim territoresh që i ka okupuar.

Nuk ka asnjë dokument historik që mund të dëshmojë se shqiptarët kanë okupuar qoftë edhe një metër të tërritorit të huaj. Këto janë të vërtetat për tua mbyllur gojën Serbisë e Rusisë dhe për tua hapur sytë atyre shteteve që u besojnë atyre.

Mërgata dibrane në pushimet verore

Të ndihmohet arsimi i lartë në Dibër të Madhe

Nga: **REXHEP TORTE**

Ditëve të korrikut vjen duke u shtuar fluksi i mërgimtarëve dibranë që vijnë për të kaluar pushimet verore në vendlindje. Ata si çdo vit vijnë me mijëra për tu çmallur me prindërit, të afërmit, miqtë, shokët e shoqet. Muajve të verës caktohen edhe synetet, fejesat e dasmat që këto çaste gëzimi t'i kalojnë sëbashku dibranët mërgimtarë dhe dibranët që jetojnë në vendlindje. Gjatë pushimeve verore janë mundësi që të rinjtë të krijojnë lidhje fejesash e martesash, me të vetmin qëllim për të shpëtuar nga asimilimi në mërgim dhe për t'i ruajtur aqë sa ka mundësi traditën, doket e mentalitetin dibran. Në dasmat dhe ahengjet dibrane çdo verë shpenzohen miliona euro. Në SHBA ka afër 15 mijë dibranë. Dibranë ka edhe në Kanada, Evropë e gjer në Australinë e largët. Mërgatëa dibrane në shtetet ku jeton ka veprimtari dhe biznese tejet të suksesshme. Pasuria e tyre vlerësohet në miliarda dollarë. Sasi të mëdha parashë janë depozituar edhe në bankat ku punojnë e jetojnë. Për fat të keq investimi i dibranëve në vendlindje është i pakët. Kjo ndikon në rritjen e papunësisë dhe në largimin e vazhdueshëm të të rinjve drejt mërgimit. Çdo e treta shtëpi dibrane është e mbyllur me çelës dhe hapet vetëm kur mërgimtarët vijnë për pushime. Mërgimtarët dibranë thonë se e duan vendlindjen, e duan Dibrën e Madhe. Kjo më shumë thuhet me fjalë, për t'ia bërë qejfin vetes, se sa me vepra konkrete duke themeluar ekonomi të vogla e të mesme vende pune për të rinjtë..

> Tani që me nismën dhe angazhimin e pushtetit vendor po bëhen përgatitjet që për herë të parë në historinë e Dibrës së Madhe të fillojë mësimi sipëror me fakultetet e hapura, mërgata dibrane duhet ta japë kontributin e saj për ta nderuar veten dhe në të mirë të tërë dibranëve e më gjerë.

Mërgata dibrane u tregua indiferente edhe gjatë periudhës së privatizimit në Dibër të madhe . Asnjëri nga mërgimtarët dibranë nuk vuri dorë të blejë dhe të aktivizojë ndonjërin nga objektet ekonomike të falimentuara. Kjo ndodhi edhe me fabrikën e dëgjuar të qilimave, ku dikur punonin afër një mijë punëtorë e punëtore, ndërsa sot është rafshuar për toke dhe nuk gjendet asnjë gjurmë e saj. E njejta gjë ka ndodhur edhe me kombinatin bujqësor që dikur lulzonte e begatonte dhe me ndërmarrje tjera. Dibranët nuk lypin lëmoshë.Ata kanë sedrën dhe dinjitetin e tyre. Ata kërkojnë të kenë ku të punojnë dhe me djersën e ballit ta fitojnë kafshatën e bukës dhe të krijojnë ardhmërinë e tyre, ku do të kishin leverdi të ndërsjellë edhe pronarët e ndërmarrjeve edhe punëtorët. Kjo do të ishte mënyra më e mirë për tu zhvilluae e mbrojtur Dibra nga boshatisja dhe nga kolapsi ekonomik.

Tani që me nismën dhe angazhimin e pushtetit vendor po bëhen përgatitjet që për herë të parë në historinë e Dibrës së Madhe të fillojë mësimi sipëror në fakultetet e dispersuara, mërgata dibrane duhet ta japë kontributin e saj për ta nderuar veten dhe në të mirë të tërë dibranëve e më gjerë.



KALENDARI
"DIBRA 2011"
merr pjesë edhe ti...
tel. 04-2233 283
email: mbbotime@gmail.com

aktualitet

SPITALI RAJONAL I PESHKOPISË

630 mijë euro investime



Kompleksi i Spitalit Rajonal të Peshkopisë, ndër më të mëdhenjtë në gjithë veriun e vendit tonë, në kuadër të reformës në shëndetësi, ka përfituar një fond investimi prej 630 mijë euro. Nga ky fond investimi 460 mijë euro janë dhënë për blerje aparaturash të reja dhe bashkëkohore dhe 170 mijë euro për rikonstruksion objektesh spitalore. Drejtori i këtij spitali, mjeku i mirënjohur dhe me përvojë të gjatë profesionale, Nazmi Kaja edhe pse ka pak muaj në këtë detyrë, ja ka ndërruar vërtet pamjen këtij spitali. Aktualisht Spitali Rajonal i Peshkopisë mbulon me shërbim shëndetësor një territor me shtrirje të madhe gjeografike, me rreth 240 mijë banorë. Nga 19 shërbime shëndetësore , thotë drejtori Kaja, për momentin mbulojmë vetëm 14 shërbime të plota dhe 2 shërbime me kohë të pjesshme, për mungesë burimesh njerëzore në personelin e kualifikuar mjeksor. Ndër arritjet e momentit që evidenton drejtori, janë përmirësimi i kushteve për pacientët në të gjithë repartet e spitalit, paisja me aparatura të reja të nivelit bashkëkohor siç ka qenë paisja me dy shtretër me telekomandë e dhomës së reanimacionit, aktivizimi i personelit mjeksor në nivelin e duhur, higjienë e pastërti shëmbullore brënda e jasht kompleksit spitalor, janë disa nga arritjet në punën drejtuese të mjekut Nazmi Kaja. Pacientë të shumtë të këtij spitali shprehen për "Rruga e Arbërit" se shërbimi mjeksor ndaj tyre është i mirë dhe se nuk janë përballur me mungesë të ilaçeve për kurimin e tyre, siç dëgjojmë rëndom të ndodhë në spitale të tjera të vendit. "Pastër, mirë e bukur na shërbehet, thotë një pacient i shtruar në pavionin e kirurgjisë. Asnjëherë më parë nuk na është ofruar një shërbim i tillë e përfundon fjalën e tij ai". Ndërkohë drejtori i ri i spitalit Nazmi Kaja, thotë se shumë shpejt brënda këtij viti, spitali do të paiset me aparatura dixhitale për skopi-grafi dhe skaner. Përparësi në punën tonë, vijon të tregojë ai, mbetet kompletimi me aparatura i laboratorit të analizave, përmirësimi i kushteve të ambientit, si dhe rikonstruksioni i morgut. Siç dihet pzrej vitesh në kompleksin spitalor të Peshkopisë, lë shumë për të dëshiruar godina e spitalit infektiv e cila është rrënuar tërësisht. Por, edhe për zgjidhjen e këtij problem drejtori Kaja, është tejet optimist. Kështu sipas tij, është rivënë në lëvizje një projekt i herëshëm që një firme italiane ka ofruar për rikonstruksionin e kësaj godine, ku pritet të marrë udhë brënda këtij viti

H.L.



Më shumë se 100 mijë banorëve të rretheve Mat e Bulqizë janë të shqetësuar pas deklarimeve të Ministrit të Shëndetësisë, Petrit Vasili për pakësimin e shtretërve në spitalet lokale dhe rajonizimin e spitaleve në qendër të qarqeve. Askush nuk mund të jetë kundër reformave që sjellin progres, që rrisin shërbimet dhe i afrojnë ato tek qytetarët, por të detyrosh pacientët të udhëtojnë më shumë se 100 kilometra është mëkat. Do nisem nga përjetimi i ditëve të fundit në spitalin e Burrelit. 3-4 gra shtatzana, në pamundësi për të lindur në matarnitetin e Burrelit, pasi nuk mund të kryhej operacioni i tyre, janë dërguar në spitalin e Lezhës. U ndodha në mjediset e spitalit "Xhavit Mara" dhe mbeta i befasuar sesi pas shumë vitesh mjekët e talentuar të Burrelit nuk arrinin t'u vinin në ndihmë këtyre nënave në nevojë. Vazhdojmë më tej. Në rrethin e Bulqizës punojnë në sektorët minerarë më shumë se 1000 minatorë. Të shumta kanë qenë aksidentet në galeri dhe gati në të gjitha rastet kanë munguar mjekët specialistë, duke ndikuar në ndonjë rast në humbjen e jetës së fatkeqëve të kromit në Bulqizë. Drejtoresha e spitalit Burrel, Xhevahire Hoxha tregohet mjaft e sinqertë kur tha publikisht se spitalin e Burrelit mund ta mbyllin mjekët që janë larguar e po largohen çdo ditë. Ajo pohoi se "Unë nuk kam dhënë dhe nuk jap kurrë pëlqimin tim për transferimin e mjekëve. Ata (mjekët) mund ta rregullojnë në ministri largimin nga Burreli". Po ashtu Hoxha shtoi se mjekët dhe specialistët që dërgohen në specializim për llogari të spitaleve burrel, Bulqizë e Dibër nuk zbatojnë kontratën e nënshkruar dhe nuk rikthehen në këto qytete, por gjejnë rrugë e mënyra për t'u rehatuar në Tiranë, Durrës apo gjetkë. Ministri Vasili është shprehur për reformë në sektorin e shëndetësisë. Askush nuk është kundër tij por dikasteri duhet të dijë: A është infrasktruktura që të trasportohet një i sëmurë në komoditet drejt spitalit të Lezhës a Dibrës, ku rrugët janë gropa-gropa që dhe i shëndoshë të jesh bëhesh me frakturа! E dyta, a është në të njëjtin nivel gjendja ekonomike e një qytetari shqiptar psh me atë anglez ku merret përvoja, dhe ku duhet thënë se rroga e një shqiptari të mesëm është dy herë më e vogël se asistenca e një mërgimtari tonë në Angli!...E treta, për 20 vite, sa të siguruar janë qytetarët shqiptarë, dhe sa u shërbehet në bazë të kësaj skeme, kur këtu nëse nuk ke para të paguash në dorë, më mirë vdis i qetë në shtëpi se t'i drejtohesh spitalit për të "vdekur" ekonomikisht tërë robt e shpisë! Mund të drejtosh njëqind pyetje që i japin të drejtë arsyetimit se spitalet tona nuk duhet të jenë vetëm të rajonalizuara dhe se spitalet në qendër rrethe kurrsesi nuk duhet të kthehen në qendra ambulatore urgjence, kjo do të ishte shkatërrimi i jetës në këto rajone. Ndaj do të ishte e udhës të ishte ai mekanizim funksonal si më parë, ku merret në konsideratë numri i popullisë dhe gjeografia e sipërfaqja e çdo rrethi, për t'i modernizuar këto spitale me aparatura sidomos kirurgjitë, laboratoret, vendet e diagnostifikimit të shpejtë, ndërsa në spitalet rajonale të kishte reparte më moderne dhe ku jepen shërbime shërbime të planifikuara dhe të specializuara. Nga ana tjetër do ishte krejt normale që këto spitale qendër rrethe të stimuloheshin me mjekë të mirë e këta të fundit të stimuloheshin dhe nga pagesat ashtu sic bëhet me mjekët e fshatrave, duke shtuar kontrollin e fortë, pasi disa syresh më shumë rrijnë në klube qytetesh sesa tek banorët e fshatrave!

Hasan PASHA

KËSHILLI BASHKIAK I BURRELIT LETËR BERISHËS E VASILIT:

"Na gjeni doktorë për të sëmurët"

BURREL-Këshilli Bashkiak i Burrelit ka diksutuar gjatë këto ditë për shërbimin shëndetësor në këtë rreth. Fakti që prej javësh nuk kryhen operacione në repartin e kirurgjisë dhe atë të gjinekologjisë ka shqetësuar të gjithë këshilltarët e Burrelit. Prej ditësh në qytet është krijuar një situatë shqetësuese sepse drejtuesit e shëndetësisë në këtë qytet janë shprehur se Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar uljen e numrit të shtretërve në pavionet e spitalit të Burrelit, kanë pohuar se shumë mjekë specialistë mungojnë dhe të tjerë vazhdojnë përpjekjet për t'u larguar dhe se është vendosur rajonizimi i spitaleve në qendrat e qarqeve, duke suprimuar spitalet lokale në qendra shëndetësore. Kanë mjaftuar këto argumenta që këshilltarët e Burrelit L. Vani, A. Farrici, N. Mallunxa, I. Përlesha të ngrënë zërin dhe t'i kërkojnë Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë të marrin masa për zgjidhjen e këtij shqetësimi serioz. Këshilltarët thanë se "prej ditësh gratë shtatëzana që duhet të lindin me operacion dërgohen në spitalin e Lezhës, pasi ky shërbim nuk u është afruar në Burrel. Po ashtu kemi dëgjuar se ministri Vasili ka vendosur të ulë ndjeshëm numrin e shtretërve në këtë spital. Kjo me siguri do të çojë në reduktimin e specialistëve dhe fondeve për spitalin "Xhavit Mara". Kjo është totalisht e padrejtë dhe shqetësuese për 70 mijë pacientët e Matit dhe mijëra të tjerë të Bulqizës. Ka njëqind arësye që Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Shëndetësisë të rishikojnë vendimet e marra dhe të mos largojnë shërbimin shëndetësor nga qytetarët, ndryshe ne do të bashkohemi me qytetarët në protesta masive"-janë shprehur këshilltarët e Burrelit. Ata thanë se do t'i drejtohen me një letër Kryeministrit Berisha dhe Ministrit Vasili dhe do t'u kërkojnë atyre të ndërhyjnë për të ndalur rrënimin e spitalit të Burrelit. Kryetari i Bashkisë Burrel Skënder Lleshi tha se "ne nuk jemi kundër reformave dhe fqizimit të spitaleve rajonale. Në spitalin e Burrelit vetëm 12 % e shtretërve shfrytëzohen dhe ulja e numrit të tyre është e arësyeshme kur dihet se shteti financon për to. Edhe lëvizjen e mjekëve nuk e frenojmë dot, por është dikasteri i Shëndetësisë që duhet të marrë masat e duhura për sigurimin e mjekëve specialistë në spitalin e Burrelit. Nuk duhet të mbyllen shërbimet aktuale në urgjencë, pediatric, kirurgji, pathollogji, gjinekologji, etj"-tha kryebashkiaku i Burrelit. Ai shtoi se ndan të njëjtin mendim me këshilltarët për t'iu drejtuar qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për gjendjen e krijuar në spitalin e Burrelit. "Ne duhet t'i kërkojmë ministrit aktual të marrë masa për sigurimin e mjekëve specialistë në këtë spital"- përfundoi Lleshi. Ndërkaq banorët e Matit kanë deklaruar për mediat se nëse shkurtohen shërbimet spitalore ato do të dalin në protesta, do të bllokojnë rrugët nacionale dhe do të hyjnë në grevë urie. **/H.P**

MJEKËT E BURRELIT DHE BULQIZËS:

Jo rajonizimit të spitaleve në qendër të qarqeve

Rruga Arbërit nr. 51

reportazh

Festa e Korabit

Mirë se vini në Radomirë!

Mbi 50 makina e disa furgonë, me banderolat "Mirë se vini në Radomirë" u panë mëngjesin e 26 qershorit në Paskuqan. Dhjetra radomiras, të moshuar e fëmijë, gra e vajza, të rinj e të reja, të ardhur nga Tirana, Durrësi e jashtë kufijve, u mblodhën së bashku për të vizituar tok Radomirën, vendlindjen e tyre dhe të prindërve të tyre, në atë që pas kësaj ditë do të quhet "Dita e Korabit".

Në anën tjetër, në Radomirë, dita do të lindë me herët. Fshatarët janë bërë gati dhe po presin vëllezërit dhe fëmijët e tyre, në një fundjavë feste, gëzimi dhe malli.

Gëzim për pritësit, gëzim edhe për ne që do të shkonim në fshatin e lindjes. Të gjithë shprehnin miratimin për këtë nisëm dhe falënderonin nismëtarët. Hajredin Madanës, Ramazan Himës, Sajmir Himës, Adem Domit, Vehap Dakut iu shtuan shumë të tjerë si Zaim Kupa, Shkëlqim Kupa, Shefit Gjoniku, Rexhep Gjoniku, Hekuran Daku, Nurish Ahmati, Riza Gjorgji, Murat Gjoniku... etj.

Ky organizim ishte një detyrim për vendlindjen tonë, ishte respekt për Radomirën, për vendin ku lindëm e u rritëm, për vendin ku kemi rrënjët tona, varret e të parëve.

Detyrimi për vendlindjen është detyrim ndaj Atdheut.

Të rinjtë qeshnin e gëzonin, të moshuarit kënaqeshin, uronin, miratonin dhe nuk e fshihnin lotin. Kishin të drejtë, po shkonin në Radomirë të organizuar. Ishin shumë krenarë se po bëheshin pjesë e një traditë të re të një brezi të ri. Nipërit e tyre, të ulur nëpër vendet e para të makinave luksoze u sillnin kujtime të rinisë, kohën kur rrugën e bënin në këmbë, me ditë të tëra cfiliteshin për të ardhur në fushë për punë, flinin nëpër hanet e rrugës apo në natyrë, në shi e borë, në roje të blegtorisë. Ruanin me sakrificat më të pabesueshme mallin e tyre, se nuk donin të shtrinin dorën... Kujtojnë edhe policinë e kohës që nuk i lejonte të shtegtonin me bagëti... Këto kujtonte Kasem Hima, Destan Domi, Ethem Madana para nisjes...

Makina e parë e autokolonës me Radomiras valëviste lart një flamur.. Flamurin kombëtar, që Radomira nuk e hoqi për asnjë çast nga kryet e vendit, nuk e hoqi nga dasmat...

Si një autokolonë dasme malësore, pa zhurmë e bujë, makinat u nisën drejt Radomirës nëpër Rrugën e Kombit... Ndalesa e parë. Tuneli i Kalimashit. Kënaqësi e krenari te të gjithë për këtë kryevepër. Kalojmë tunelin modern dhe për pak minuta në Kukës. Ëndrra u bë realitet. Kjo ëndërr shpejt do të bëhet realitet edhe për "Rrugën e Arbërit" e atëherë, kësaj autokolone të gëzuar, dy orë do t'i duhen për të shkuar në Radomirë.

Ndalesa e radhës te Qafa e Kolesianit. Pritje, respekt e kuriozitet nga banorët e rastësishëm. Kur përmendet Qafa e Kolesianit, kujtohet një pjesë tepër e rëndësishme dhe e ndjeshme e historisë së kombit. Beteja e nëntorit 1912 qe vendimtare për fatet e Shqipërisë. Oreksit të Serbisë për zgjerim përmes okupimit i kundërvihet vegjëlia e Lumës me Ramadan Zaskocin, Islam Spahinë etj., por dhe me ndihmën e dibranëve trima me Elez Isufin. Në këtë betejë Serbia mori goditjen më të madhe ku humbi 12 mijë ushtarë. Mërinë për këtë humbje nuk e harroi kurrë dhe do ta shprehte më vonë me djegiet masive dhe me krimet më të paimagjinueshme duke vrarë e prerë me mijëra lumjanë e dibranë, e duke bërë shpërngulje masive. Këtu Radomira, pas afro 100 vjetësh, erdhi për të përkujtuar të parët e vet në atë betejë që është quajtur "Termopilet shqiptare". Solemnitet i thjeshtë, por shumë mbresëlënës. Më të moshuarit dhe më të rinjtë zënë vend para lapidarit. Pak fjalë zemre dhe shumë kujtime të transmetuara nga të moshuarit për ato ditë. Ato ditë historike Bajraku i Radomirës erdhi me më shumë se 300 luftëtarë, të gjithë me kuaj të bardhë të udhëhequr nga Ibrahim Haxhi Gjorgji (Brahimi i Haxhi Zeqirit), të veshur me "fundin e arkës", se kështu, bukur e pastër visheshin luftëtarët që përgatiteshin për të vdekur për Atdheun. Të gjithë ishin përgatitur për dëshmorë. Sipas dëshmive, Radomira erdhi më vonë, se ishte më larg. Pasi njihet me vendimet e shtabit te luftës për ta filluar atë në mëngjesin e nesërm. Ibrahimi shpreh shqetësimin se deri ditën tjetër ushtrisë serbe mund t'i vinin përforcime e s'mund të përballohet, prandaj duhej goditur menjëherë. Dhe dy vargjet e këngës së atyre viteve dëshmojnë qartë këtë:

Brahim Zeqiri fluturon si zogj,
Nuk e lamë për nesër, do t'i biem sot".

Pasi ia shpreh shtabit vendimin e Bajrakut, sulmon i pari me bajrak në

> Mbi 50 makina e disa furgonë, me banderolat "Mirë se vini në Radomirë" u panë mëngjesin e 26 qershorit në Paskuqan. Dhjetra radomiras, të moshuar e fëmijë, gra e vajza, të rinj e të reja, të ardhur nga Tirana, Durrësi e jashtë kufijve, u mblodhën së bashku për të vizituar tok Radomirën, vendlindjen e tyre dhe të prindërve të tyre, në atë që pas kësaj ditë do të quhet "Dita e Korabit".

dorë. Kaq u desh, lufta u ndez masivisht, por Brahimi goditet i pari dhe shpejt vdes. Gjaku i tij dhe i shumë të tjerëve në këtë betejë u bë garancia e asaj fitoreje madhore.

Autokolona niset nëpër rrugën që po hapet dhe asfaltohet dhe shumë janë të mendimit se kjo po bëhet me parametra më të mirë se segmenti Peshkopi-Kala. Deri në Bushtricë kalohet pa problem, por pjesa për Kala të Dodës qe tepër e vështirë.

Megjithatë, u kalua dhe tjetër eveniment për udhëtimin tonë: telefonojnë nga Radomira se na presin te Qafa e Kalasë, te Fusha e Madhe. Gëzim tjetër te të gjithë.

Aktiviteti, i nisur në fillim si me drojë e me njëfarë pasigurie, po i kalon parashikimet. Një autokolonë tjetër na priste në një kodër të gjelbëruar nga ku syri të rrok Lumën, Dibrën e Korabin. Një shtrëngim duarsh në këtë takim mirëseardhje-je. Kamerat e Shefit Gjonikut e Berzah Dakut janë në punë. Shefiti e ka filluar që në mëngjes punën. Fotografi, filmime, biseda, valle në Fushën e Madhe. Të gjitha toponimet e kësaj hapësire dëshmojnë historinë dhe lashtësinë e kësaj zone mahnitëse.

Kalaja e Dodës, që sot emërton shumë fshatra duke filluar nga Kalisi, Vila, Bushtrica, Çaja, Fshati, Buzmadhja e duke përfshirë 5 fshatrat e komunës me të njëjtin emër: Shulla, Vasie, Ploshtan, Ceren e Radomirë. Përcaktorin "E Dodës"e mori para afro 400 vjetësh kur Zenel Agë Doda nga Dodet e lashtë poshtë Ploshtanit, vuri dorë mbi objektin e quajtur "Kala". E mbrojti nga sulmet e spahinjve të Dibrës (Vilajeti i Manastirit) dhe të Lumës (Vilajeti i Kosovës), se njëra palë e kërkonte kufirin te Ura e Lapave e tjetra në Veleshicë. Secila palë kërkonte zgjerim zonash për të mbledhur taksa. Ishte quajtur herët "Qafa Bilbili" e "Kalaja e Qafës". Thuhet se Kalaja nuk ka qenë te vendi ku është emërtimi i sotëm e ku dëshmohet vetëm përmes një objekti të tipit kazermë me funksione ushtarake. Ka pasur edhe funksione administrative. Afër vendit ku u pritem është "Tabja e nizamëve", lartësi të cilën turqit e përdorën për funksione ushtarake për vetë pozicionin strategjik që ka.

Autokolona vihet në lëvizje në udhën e ngushtë Ploshtan-Ceren pas përcjelljes dashamirëse të ploshtanasve dhe cerenasve që u ndodhen. Rruga Ceren-Radomirë është e mirëmbajtur nga komuna dhe na e lehtëson udhëtimin. Arrijmë në Tejs, pak anomali në parkim dhe takime të përmallshme. Kanë dalë thuajse të gjithë. Ata që punojnë në bjeshkë e që do të na presin të dielën atje, kanë zbritur sa për të na uruar mirëseardhjen e për t'u ngjitur përsëri. Një pasdite e veçantë pas një nisjeje të veçantë. Vizita nëpër familje, kafe nëpër lokalet e reja të Haxhi Himës, Sutki Ahmatit, Bujar Hoxhës e Iliaz Ahmatit. Baxhierët Sulë Ahmati e Hysen Tabulli na gostitin me djathin me nam të Korabit. Kanë ardhur banorë edhe nga Çernjeva, Derbaçi, Radet e Stërdoku. Të gjithë na ftojnë, të gjithë janë përgatitur, shumica kanë prerë qingja për pritje. Shpërndahemi vonë për t'u mbledhur në orën shtatë të së nesërmes. Miq e pritje në çdo familje, natë thuajse e pagjumë dhe mëngjesi i shumëpritur...

Kraiti në Tejs deri te Ura e Krreçit, ku janë dhe lokalet, u mbushen plot me njerëz. Shumë udhëtuan natën nga Tirana për t'u ndodhur në mëngjes në Radomirë, përshëndetje të tjera mirëseardhjeje. Zoti na plotësoi lutjen. Pas së shtunës pasdite me shi, e diela doli qelq. Gjithë meraku ishte te koha, ajo vendoste për fatin e festës. Nisemi. Të moshuarit, që nuk janë të paktë, udhëtojnë me kuaj.

Ngjitje e vështirë, por lodhja nuk ndihet, burimet e shumta me ujin e akullt si Kroi i Sheles, i Gjustava-



Ku kam qarë për herë parë

Radomirë, o mirë se t'gjeta!
Radomirë, o tungjatjeta!
Mos mendo se t'kam harrue,
Prandaj erdhëm me t'kujtue.

Ti je gdhendur në kujtesë,
Të kemi shpirt e t'kemi zemër.
Ti për ne nuk je harresë,
Po ti je e bukra ëndërr.

O vendlindja jonë e dashur,
Ku ne qamë për herë të parë,
U larguam me zemër t'plasur,
Erdhëm borxhin për të larë.

Për herë t'parë tek ty pamë qiellin
Për herë t'parë tek pamë diellin
Për herë t'parë tek ty pamë hënën,
Për herë t'parë tek ty pamë nënën.

Radomirë, o Radomirë,
Kurrë s'do t'themi lamtumirë,
Eh, sa shekuj do kalojnë,
Brez pas brezi do t'kujtojmë.

MYHYR HOXHA,
bir i Radomirës

opinion

icës, i Rafshës na shuajnë etjen, na gërryejnë stomakun për oreks.

E oreksi do të shuhet me mishin e mbi 20 qingjave që janë në kazanat e rinj e që valuan që në orën gjashtë të mëngjesit atje te Guri i Kupllarëve nën kujdesin e Ajetit, Ibrahimit, Shabanit etj. Janë përgatitur gjellët e krahinës, përveç djathit origjinal, nuk mungoi edhe hallva e punuar me mjeshtëri nga Shaban Ahmati.

Mori tjetër gjallëri Korabi atë ditë. Njerëzit, grupe-grupe bisedojnë, kënaqen, urojnë. U duket e pabesueshme. 90-vjeçari Kasem Baloshi e ke vështirë të flasë nga emocioni. Kasem Hima flet me djalin në Amerikë dhe i thotë shkurt: "Jam në xhenet". Parajsë është bjeshka që e lindi dhe e rriti për 70 vjet. Ismail Ahmatit, pas një aksidenti që pati kaluar, nuk i besohej se mund ta shihte më Korabin, por e arriti dhe vetëm uron. Ethem Madana, me atë trupin vigan, që nuk e ndien moshën, duket pak i përhumbur në kujtime. E shumë e shumë të tjerë kështu. Hajredin Ahmati me vëllain, Nurishin, kanë marrë nga Tirana disa çadra se do të" bujnë" tri net në Korab me gjithë familjet.

Shumica e pjesëtarëve të familjes nuk kanë lindur në Radomirë, vijnë për herë të parë. Kështu transmetohet tradita. Kaq njerëz të mbledhur njëherësh nuk ka parë Korabi. Janë mbi 400, të gjitha moshat, gra e vajza.

Ora 10 e 30. Pas një pushimi, pjesëmarrësit ulen në formë rrethi. Si në sofër. Shume emocione, çdo gjë sipas një programi që në fakt vetëm ishte imagjinuar dhe jo shkruar. Një rreth vigan i mbyllur me njerëz të shtruar në sofrën e madhe të Fushës së Korabit. Na shkon ndër mend kënga - epope e kurbetit. Jemi afër "Udhës së Pazarit" ku kalonin mërgimtarët që shumë shkonin, por më pak ktheheshin. Vargjet e këngës "Moj Fushë e Korabit / Taj na erdhe hakit / Taj na dave shtratit" duket sikur i përkasin një epoke tjetër. Janë afër e larg. Afër se të vërtetën e këtyre vargjeve kjo zonë akoma e ruan. Janë të shumtë ata që mbeten në Stamboll etj, e akoma ruajnë lidhjet. Janë larg se po kjo Fushë, sot po bën të kundërtën: i bashkoi Radomirasit.

Këtë "mexhlis" vigan e uron veterani 88-vjeçar Fehmi Ahmati, që sot duket si një i ri. Uron me fjalë zemre, uron të ardhurit, përgëzon ata që punuan për të krijuar këtë atmosferë. Uron që kjo ditë të jetë e përvitshme, uron dhe miqtë e ftuar të fshatrave të tjerë të Kalasë, por dhe ndonjë dashamirës i ardhur nga Tirana. Dhe askush nuk e ka mendjen tek mishi i shijshëm e i bollshëm, por te vallja që ndizet në moment nga curlet e lodrat e zonës. Valle me qindra vetë. S'është parë kurrë kjo! Aktorë janë të gjithë! Spektatorë është Fusha e Korabit. Është Luftina që akoma ruan gjysmën e borës së dimrit, është Pesoki, që sheh prej matanë piramidës e thërret "Jam pjesë e juaja, por na ndau 1913-a". Dhe ky vit ogurzi ndan bjeshkët e Radomirës.

Në valle janë dhe fëmijët, dhe barinjtë që sot i lanë delet vetëm, dhe të moshuarit, që ndofta s'e provuan kurrë këtë art, por sot është ditë ndryshe. Jehon dhe "Kënga për Radomirën" e kënduar me pasion e me atë zërin e veçantë nga këngëtari Arif Madana. Uron me dlirësi e art biri i Radomirës, autori i qindra këngëve, poeti i emocioneve, Munir Hoxha.

Ky entuziazëm i nisur sot do të trashëgohet çdo vit. Ky është një premtim i të gjithëve. Me këtë premtim që njerëzit filluan ta uronin me thënien "Për shumë vjet" u afrua dhe fundi i aktivitetit të madh për të vijuar me futboll, biseda në grupe, vizitë në Panair e matanë piramidës. Kënaqësia e mundi lodhjen. Përmes kthimit edhe vizita në pika të tjera përrallore: në Presh, Çishkravë, Rebi, Liqeni i Zi etj. Kthim në Radomirë, një pjesë largohen pasditen e së dielës, shumica përsëri vizitorë. Dhe në fund një ndarje me premtimin që çdo vit e më mirë të festohet "Dita e Korabit".

JAHE SELMANI



"Djemtë e Radomirës"

Nga: JAHE DELIA (SELMANI)

Prej mijëra vjetësh, aq sa është i lashtë edhe Korabi madhështor, në këto rrafshe e kreshta janë mbledhur të paret tanë, por nuk paten rastin fatlum të mblidhen si ne sot.

Ata vinin nga Çernjeva, Derbaçi, Radet, Sterdoku e Tejsi me dy lloj veglash:veglat e çobanit për të mbarështruar delën rudë, racën më të fortë e më të bukur të Ballkanit dhe pushkën për të mbrojtur këto bjeshkë e këto male. Eshtrat e shumta të shpërndara nëpër bjeshkën më të bukur jo vetëm të Ballkanit, me varr e pa varr, tregojnë se sa gjak e djersë u derdh për ta mbrojtur këtë vatan.

I kujtojmë me respektin më të madh, perkulemi para veprës së tyre, u premtojmë se do ta ruajmë amanetin e tyre. Ata na pështëndesin nga altari i shenjtë, na miratojnë, na ftojnë që kurrë të mos harrojmë.

Miku ka qenë bashkë me besën , institucioni më i shenjtë i mikpritjes shqiptare. Peshendetje dhe nderime per ta dhe i urojmë me formulen më të lashtë për këte rast;

"Mirë se erdhet, bukë e krip e zemer!

Të paktën një dhjetëvjeçar ka zier mendimi për të ardhur kështu të organizuar në katundin më të bukur në botë, në Radomirë, në bjeshkën më madhështore, në Korab, por s'qe thënë. Fati shpesh të përndjek, ashtu siç përndoqi shumë vëllezër katundarë tonët që nuk arritën ta realizojnë ëndrrën për të ardhur në këtë ditë të shënuar. I përkujtojmë me lot në sy dhe u përgjigjemi me formulën më të shkurtër e më domethënëse kosovare: "E KRYEM"

Ne i kemi pasur, i kemi dhe do t'i kemi punët të pandara, gëzimin e kemi shijuar bashkë, siç kemi derdhur bashkë edhe lotët e dhimbjes. Ne erdhëm nga larg ta shijojmë këtë ditë të madhe këtu në vendlindje me vëllezërit tanë , që janë dhe mikpritësit. Dhe ai që pret ka më shumë detyra, më shumë shqetësim. I falënderojmë për mikpritjen, për mundin e madh, se nuk është e lehtë të organizosh një aktivitet në Korab me mjetet tradicionale të transportit. Gjithashtu, ju themi se gjithçka është mirë si herë e parë, se më i mirë është qëllimi i ardhjes dhe se herën tjetër do ta bëjmë edhe më mirë.

Nuk mund të rri pa përshëndetur edhe gjithë ata që erdhën nga fusha që e kanë pritur këtë ditë si ditë rilindje, ata në mbështetën në këtë nismë të gëzueshme, njoftuan njëri- tjetrin, realizuan një amanet që do ta përcjellim më tej.

Janë shumë emra që jo vetëm u morën me organizimin, por disa ofruan edhe sponsorizimin e aktivitetit të së dielës me 27 Qershor 2010. Duke i falënderuar, u themi se ndihma e tyre do t'i duhet Radomirës me vonë dhe të tillë dhurues besoj se do të shtohen.

Pas kësaj dite realiteti dhe ëndrra janë më afër te unë. Sot jemi aq sa jemi këtu, nesër shumë më tepër pjesëmarrje, se Radomira është shumë herë më e madhe, ajo i ka bijtë në gjithë globin. Sot kemi ardhur jo pa vështirësi, por "Rruga e Arbrit" dhe "Peshkopi-Kala e Dodës" do ta bëjnë më të lehtë nesër; sot kemi ardhur në këmbë në Korab, por nesër e shoh ndryshe; ato makina moderne të fituara me djersë do të gjarpërojnë rrugës së merasë, nga Elpthi në Shkallën e Preshit e do të shkëlqejnë në Rrafshën e Korabit. Mua nuk më duket çudi, as ju nuk duhet t'ju duket, se brezi i ri do të bëjë çudira.

Nuk do jetë e largët dita kurë këto bjeshkë do të gjallërojnë më shumë jo vetëm nga ne, që jemi pjesë e tyre, por edhe nga të ardhur, se në gjirin e tyre secili ndihet mirë. Këto të dhurojnë ujin e ftohtë, qetësinë, gjelbërimin, madhështinë.

Ne i kërkojmë falje këtij vendi të bekuar se në 50 vjet nuk bëmë gjë për të. Nuk mundëm ta mbronim nga betonet që plagosen trupin e butë të bjeshkës, "brezi i butë" i famshëm akoma qëndron si plagë e thellë thike mbi trupin e saj, kazmat vend e pa vend të gjeologjisë e kafshuan si dhëmbët e ujkut trupin e qengjit. Arritën deri atje sa t'i heqin edhe gëzofin që e pati mbrojtur me mijëra vjet, dëllinjën e gjelbër që jo vetëm ruante lagështinë, por dhe e ruante nga gërryerjet. Dhe rezultatet i shohim të gjithë, bari digjet para kohe, përmbytjet ndodhin me shiun më të vogël.

Këto nuk do të përsëriten më. Ju që banoni këtu dhe ne që jemi më larg kemi të njëjtën përgjegjësi për ta ruajtur nga kushdo që do të vërë dorë për ta prishur. Komisioni i Radomirës, që ka bërë vepra të mrekullueshme në shekuj, duhet të jetë përherë aktiv, kërkues edhe ndaj nesh, edhe ndaj shtetit, kur ka ndërhyrje në dëm të Radomirës.

Ky fshat, kur kishte i dha ujë Kukësit dhe jemi krenar për atë që kemi bërë e njëkohësisht na vjen keq që s'kemi më qe t'i japim, se uji u mor nga të tjerë. Uji i Korabit gjallëron Dibrën, por u punua brutalisht, ujët humbi dhe sot rrezikohet në verë dhe bjeshka jonë. Jemi humanë, por duhet të pyetemi, se jemi të zotët e vendit.

Me rrugët ligjore kombëtare e ndërkombëtare, me format demokratike ne duhet të mendojmë për ato hapësira të mrekullueshme që prej afro 100 vjetësh janë matanë kufirit, me emra me rrugë, me kroje, me stane etj. Kjo padrejtësi shekullore ndofta vihet në vend në kuadrin e problemeve ballkanike, por me ato bjeshkë Korabi do të bëhej pika më e lakmuar turistike në Ballkan për turizmin veror e dimëror.

Ne u detyruam të emigrojmë brenda e jashtë vendit, por mendja na rri këtu, se ëndrrat i shohim këtu. "Djemtë e Radomirës" shquhen për punë, nder e sakrificë. Me punën e tyre kanë hijeshuar fushat e kodrat e Tiranës me vilat më të bukura. Kudo janë të respektuar dhe kanë ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme. Çdo pëllëmbë tokë e kanë hallall, se e kanë blerë e jo zaptuar. Respektojnë ligjet, fenë e zakonet për pronën e tjetrit. Këtë respekt kërkon e do të kërkojë Radomira edhe ndaj atyre që shpesh e kanë cënuar në pasuritë e veta. Kemi qenë e do jemi korrektë me fqinjët, as nuk kemi cënuar kënd dhe as nuk kemi lejuar të cënohemi.

Vetëm me këtë rrugë të drejtë ne do të bëjmë të mundur që çdo vit e më mirë ta organizojmë këtë ditë, çdo vit të shtojmë pjesëmarrjen, që jo vetëm ne që lindem e u rritem këtu, por edhe fëmijët e nipërit tanë të mëkohen me dashurinë për fshatin e origjinës.

Besojmë se do të arrihet kjo dhe jemi shumë krenarë.

"Bibollasit" është një roman që përfshin universalet absurde, nonsensin e përditshmërisë, kaosin psikologjik të një shoqërie të dalë nga diktatura. Afresku rrëfimor të rrëmben me një galeri tipash naivë, megalomanë, mashtrues, simulakër e psikopatë, por që secili bart të vërtetën e tij.

"BIBOLLASIT", një toponim alegorik i Shqipërisë postkomuniste

U prezantua më 21 korrik, mjediset e librarisë "E për7shme" në Tiranë, romani "Bibollasit" i autorit Ramiz Gjini.

I njohur dhe i konfirmuar prej kohësh si një ndër mjeshtrit e padiskutueshëm të prozës sonë të shkurtër bashkëkohore (për çka flet dhe interesimi i përkthyesve të huaj, me botimin e përmbledhjes së zgjedhur me tregime në rumanisht, "Atdheu prej dëbore", nga përkthyesi i njohur Marius Dobresku), Ramiz Gjini ka kaluar në lëvrimin e prozës së gjatë.


Romani "Bibollasit" përbën dylogjinë satirike të "Bibollit", një toponim alegorik i Shqipërisë postkomuniste dhe është vazhdim i romanit të mëparshëm "Rrëketë". Situatat dhe skenat e shumta komike në romanin "Bibollasit" përshkohen nga humori i zi, absurd, plot elemente fantastike e demonologjike, duke krijuar një strukturë shumështresore dinamike të një rrëfimi të gjallë e sugjestionues. Është një roman që përfshin universalet absurde, nonsensin e përditshmërisë, kaosin psikologjik të një shoqërie të dalë nga diktatura. Afresku rrëfimor të rrëmben me një galeri tipash naivë, megalomanë, mashtrues, simulakër e psikopatë, por që secili bart të vërtetën e tij. Përmes këtij vëllimi, autori na zbulon diavoliadën shqiptare të kaosit individual e shoqëror.

Edhe pse personazhet janë thuajse të gjithë negativë, antiepikë e kontradiktorë, këta antiheronj janë përshkruar me dhimbje, përvuajtje e dashuri, një karakteristikë e hershme që i dallon të gjitha krijimet e Ramiz Gjinit.

Romani "Bibollasit" i Ramiz Gjinit, i botuar nga "Botimet M&B" dhe vjen pas vëllimeve me tregime "Dush varrezash", "Këpucët e të tjerëve mbi trotuar", "Atdheu prej dëbore", "Mendjet e njerëzve", "Rrëfime në hije", "Posta që sjell era" dhe romanin "Rrëketë".

Në prezantimin librit folën shkrimtarë, gazetarë dhe miq të Ramizit, të cilët e vlerësuan romanin e ri, si një kontribut në letërsinë moderne shqiptare.

Për lexuesit, po sjellim disa nga diskutimet e pjesmarrësve.



Leximi nga autori. © Fotot e prezantimit nga Zaim Elezi (ZAYA)



AGRON TUFA: RISI NË ARTIN DHE MËNYRAT E KOMPOZIMIT DHE RRËFIMIT

Ramiz Gjini është një shkrimtar që është konfirmuar prej shumë vitesh, duke e nisur qe nga vëllimi me tregime "Dush varrezash", "Këpucët e të tjerëve mbi trotuar", "Atdheu prej dëbore", "Mendjet e njerëzve", "Rrëfime në hije" dhe romanin "Rrëketë". Nuk duhet të harrojmë që vëmendja e lexuesit të specializuar ka qenë e përqendruar në veçoritë artistike të prozës së Ramiz Gjinit. Kjo prej kohësh ka kaluar edhe te përkthyesit e letërsisë shqiptare në botë. Kemi një përmbledhje me tregime të zgjedhura "Atdheu prej dëbore", botuar në gjuhën rumune të përkthyer nga Marius Dobresku .

Sot prezantojmë pikërisht romanin "Bibollasit". Në këtë roman që është i një gjinie satirike, ngrihen probleme kryesisht të njeriut, individit dhe shoqërisë shqiptare në postkomunizëm. Është një roman që ka zgjidhur një pjesë të madhe të detyrave artistike që kanë qënë të përsëritura në tregimet e tij.

Mendoj se është një roman që shënon një risi në artin dhe mënyrat e kompozimi, rrëfimit dhe dimensioneve të tjera letrare.

Është një roman që përfshin universalet absurde, nonsensin e përditshmërisë, kaosin psikologjik të një shoqërie të dalë nga diktatura. Afreska rrëfimore të rrëmben me një galeri tipash naivë, megalomanë, mashtrues, simulakër e psikopatë, por që secili bart të vërtetën e tij.

Para nesh kemi një penë mjeshtërore, një rrëfimtar të lindur, që zbulon nëpërmjet humorit të zymtë, plot poezi, diavoliadën shqiptare të kaosit individual e shoqëror. Edhe pse personazhet janë thuajse të gjithë negativë, antiepikë e kontradiktorë, këta antiheronj janë përshkruar me dhimbje, përvujtni e dashuri, një karakteristikë e hershme që i dallon të gjitha krijimet e këtij autori.

Bibolli i tij është një kategori kohë-hapësinore marrëzish saturnale, ngërdheshëse, një bashkësi që ka dalë nga ploja diktatoriale, një pluhurnajë njerëzore psikopatologjike, e cila me thërrmijat e rrënojave të diktaturës, kërkon të ngjizë planetin e vet, ekzistencën e vet autentike, të disiplinojë kaosin individual dhe shoqëror në një farë rendi e rregulli.

XHAFER MARTINI: "BIBOLLASIT", NJË ROMAN I RI QË I MUNGON LETËRSISË SHQIPTARE.

Kam pas fatin që ta lexoj romanin Ramizit nga të parët lexues. Romanin më vuri përpara shumë vështirësive për t'u shprehur, për faktin se është një roman i ri që i mungon letërsisë sonë. Kam bindjen e plotë që ky libër do të shkaktojë diskutime të mëdha në shtypin shqiptar, sepse është një libër që patjetër do të tërheqë vëmendjen për tematikën dhe problematikën që trajton.



Romani "Bibollasit" është një roman që lexohet, sepse kjo është gjëja më themelore. Në qoftë se libri nuk lexohet, atëherë lexuesi e braktis atë. Libri i Ramizit ka veti që po ta fillosh do ta çosh deri në fund dhe kjo është një tregues i madh. Është e vërtetë që ka dhe vepra shumë madhore, të cilat lexohen me vështirësi, por këto janë raste të rralla. Ajo e përgjithshmja është kjo që letërsia duhet të lexohet dhe "Bibollasit" është një roman që lexohet.

Është një letërsi e cila ka filozofi brenda. Është një roman shumë i rëndësishëm sepse trajton disa tema shumë të rëndësishme, si p.sh.: raporti i njeriu me shtetin. Janë të rralla veprat letrare që kanë trajtuar një problem të tillë kaq të thellë edhe në gjerësi edhe në tërësi si e ka trajtuar Ramizi.

Ai është një shkrimtar popullor. Ramizi mban anën e popullit. Janë shumë të pakta ato vepra që mbajnë anën e popullit. Nga rëndësia e madhe që ka kjo vepër, të kujton "Don Kishotin e Mançes", "Ushtarin e Mirë Zhvejk", shkrimtarë të tjerë të mëdhenj, që me një llojë proze, me humor e me satirë, gjithmonë janë në anën e popullit. Dhe të jesh në anën e popullit është vepra më e madhe.

Raporti tjetër është i individit me kolektivin, me komunitetin. Edhe ky raport është shumë i rëndësishëm është i projektuar me një mprehtësi shumë të skrupuloze. Kryesorja është raporti i njerëzve me mbretërinë qiellore.

Libri ka shumë filozofi, ka estetikë, ka moral, ka politikë, ka marrëdhënie shoqërore, ka kontradiktë. Të kundërtat janë ato që e mbajnë romanin gjallë dhe e çojnë përpara me dinamizmin e madh.

Romani nga pikëpamja e strukturës nuk ka linja kompozicionale tradicionale. Ai është një roman mozaik i ndërtuar me gur, jo gur dosido, por gur manjetik që mbajnë njëri-tjetrin dhe krijojnë kohezionin e përbashkët të godinës që nuk shembet.

Kur lexova romanin kujtova se episod mbas episodi mund të shkojë shumë gjatë. Por jo. Ramizi edhe e hedh rrjetën, si ai peshkatari i mirë, por edhe e mbledh në kohën më të përshtatshme, se një sekondë ta lësh më shumë ajo nuk zë peshk. Pra, edhe nga pikëpamja e strukturës është një roman interesant. Ka satirë, ka humor, ka një humor të zi, ka groteskun, ka simbolin. Të gjitha këto janë mjete artistike që nuk mund të vihen në mënyrë të stonuar në roman por në mënyrë organike. Një roman i tillë është parabolë, është një roman ironik, është një roman ka një realitet të vetin. Të gjithë personazhet vijnë nga një çmendinë, janë të gjithë njësoj, por çmendinë është tranzicioni, është jeta, është realiteti. Gjuha është shumë interesante. Fjala në romanin e Ramiz Gjinit ka ngjyre, ka muzikë, ka peshë, është e kuptueshme dhe përcjell mesazhe.

cyan magenta yellow black




SAMI MILLOSHI: NJË REALITET SHQIPTAR I EPOKËS SONË

Unë e kam ndjekur krijimtarinë e Ramiz Gjinin që nga tregimet e para, 12 vite më parë. Ramizi është një zë origjinal në letërsinë shqipe. Ramiz Gjini ka një mënyrë të shkruari shumë të veçantë. Me lojën që ai bën me absurdin, fokuson një realitet realiteti shqiptar të kësaj epoke, i cili është memorizuar shumë mirë në kujtesën e tij. Por, përveç kësaj, Ramizi në romanin e tij ka edhe një filtrim përmes një lirie shprehjeje që ai e ka zhvillur akoma më shumë në Amerikë. Po të mbash parasysh të lexosh gjithë prozën e Ramizit, veçanërisht romanin e fundit "Bibollasit", një veçori e jashtëzakonshme e tij është humori. Ne kemi shumë nevojë për humor dhe letërsia shqiptare ka shumë nevojë për humor. E vërteta është se këtu bëhet një lloj gare për mënyra shprehjeje ose teknike të caktuara që janë zbuluar. Por, humori i Ramizit nuk është humori banal i ditëve tona, por është një humor shumë aristokrat dhe shumë fin, që do ti pëlqejë shumë lexuesit shqiptar.

Nga vëllimi i parë tek i fundit, Ramizi është shumë i saktë te fjala që hedh. Ai është i kujdesshëm dhe ka shumë respekt për fjalët.

Për ta mbyllur do të thosha që Ramizi ka dëshmuar që ka çarë dhe shpresoj se do çajë edhe në tregun Amerikan, dhe kjo edhe falë vajzës së tij, Gjelina, e cila ka përkthyer një tregim të Ramizit nga shqipja në anglisht (The Black Cat – Macja e Zezë), i cili është pëlqyer shumë nga lexuesit amerikan. (http://www. booksie. com/literary_fiction/short_story/ramiz_gjini/the-black-cat).

Letërsisë shqiptare ka probleme në botimet e saj nëpër botë, dhe kjo falë mungesës së përkthyesve profesionistë. Shpresoj që në të ardhmen të kemi sa më shumë Gjelina për të bërë të njohur Ramizin dhe shkrimtarë të tjerë seriozë e të suksesshëm në vend.





ROMANIN "BIBOLLASIT" DHE VËLLIMIN ME TREGIME "POSTA QË SJELL ERA" MUND TI POROSISNI ME TEL: (04) 22 33 283

SHINASI RAMA: "BIBOLLASIT", NJË TRAKTAT POLITIK DHE SOCIAL



Unë kam pasur fatin që ta lexoj këtë libër në disa variante, por them se ky libër përbën me të vërtetë një kontribut të jashtëzakonshëm dhe cilësor në vazhdën e trashëgimisë letrare shqipe.

Së pari, ky është një libër i jashtëzakonshëm, sepse sjell popullin në letërsi. Letërsia praktikisht e tranzicionit të këtyre viteve, me disa përjashtime, drejtohet e orientohet drejt preokupimeve të elitave, drejt individit, unit, vendit tim në shoqëri, një shoqëri elitare të imagjinuar artificiale, që vjen nga një pjesë e bllokut te një pjesë tjetër e Tiranës së re.

Ky libër sjell shqiptarin e vërtetë, fshatin e vërtetë shqiptar me çoroditjen e tij të thellë, me faktin që kanë ngelë rob të së shkuarës, me faktin që njerëzit nuk dinë me gjetë zgjidhjen as për veten e tyre as për të ardhmen, por me një sens vazhdojnë përsëri të njëjtat forma sjellje edhe forma marrëdhëniesh, të cilat kanë kushtëzuar sjelljen e tyre.

Në këtë sens ky roman për mua përbën një nga kontributet më të jashtëzakonshme, sepse na tregon për herë të parë tamam atë absurdin e tranzicionit, i cili është një tranzicion që po zgjat pothuajse sa një jetë

Në sensin politik është më tepër se një traktat. Duke sjellë fshatin shqiptar, duke sjellë dilemat e shqiptarëve të deformuar nga një sistem tjetër, Ramizi na ka dhënë të gjithëve një pasqyrë me pa veten tonë, me pa të afërmit tonë, me shmangë këtë iluzionin e absurdit, sepse jemi duke zgjidhur problemet e vërteta reale në një kohë kur ne jemi duke u marrë pikërisht me vetvetet tona dhe jemi hijet e vetveteve tona.

Pra, në nivelin politik, ky libër përbën një kontribut të jashtëzakonshëm. Është një analizë shumë e thellë dhe shumë konstitutive se çdo traktat tjetër politik.

Në nivelin shoqëror, duke na hapur këtë dritare për shoqërinë shqiptare, romani i Ramizit është një kontribut i madh sepse po sjellim një masë karakteresh, të cila janë jo vetëm reale, por janë tërësisht të injoruara në shoqërinë e sotme shqiptare. Këto janë shqiptarët e vërtetë. Ne jemi njerëzit që e shohim veten në roman.

Në nivelin artistik do të kisha thënë, se libri është i punuar me shumë kujdes. Autori jo vetëm që ka punuar mjaft mirë me fjalët, por ka demonstruar një thellësi të jashtëzakonshme kuptimi të natyrës njerëzore.

Ajo që e dallon një shkrimtar të madh nga një shkrimtar tjetër normal, është fakti sepse një personazh i tij është njësoj si vrima e gjilpërës ku përshkruhen karakteret e mijëra njerëzve, ku shumë njerëz duke e parë këtë personazh, shohin një pasqyrë ku ata gjejnë aty vetveten.

Struktura e romanit është si një mozaik. Por gjithë turma është një mozaik. Zgjidhja që ka bërë Ramizi ka qëllim të tregojë shkërmoqjen e shoqërisë shqiptare. Fakti që këto njerëz nuk lidhen plotësisht njëri me tjetrin, është fabula që zakonisht mban romanin gjallë, është pasqyrimi i fenomenit më tragjik të tranzicionit të sotëm: një shoqëri e amorfizuar, anemike, pa strukturuar, të cilat nuk krijojnë kohezionin e dobishëm që u shërben gjithë qytetarëve të shoqërisë.

Për mua personalisht ky roman përbën një kontribut të jashtëzakonshëm. Ky roman do ta zërë vendin e vet në letërsinë shqiptare. Është një roman që u mungon shqiptarëve. Është një këndvështrim që ne e kemi të nevojshëm dhe jashtëzakonisht të kohës. Po vjen në kohën e duhur dhe vjen me fuqinë e një shkrimtari që e meriton vendin e vet në pakicën e shkrimtarëve që nderon një popull.



ANDON ANDONI: NJË ROMAN QË DO TRONDISË LETËRSINË SHQIPE

Romani "Bibollasit" i R Gjinit, duhet thëne që në fillim, se me mënyrën e të shkruarit, tendencën tejet moderne të narativitetit, me një izotopi të mungesës dhe më së shumti, "të një mërzije të thellë", me një sërë teknikash shkrimi në dukje fare të thjeshta, me plot gojë, e trondit botën letrare të tashme dhe hedh dritë në fundin e tunelit të letërsisë duke rrokur më të mirën e traditës së shkuar dhe të së tashmes në zhvillim e sipër.. Romani teknikisht, siç do t'i pëlqente dhe vetë autorit të përdor këtë fjalë të tijën që nga faqja e parë, është mëse i thjeshtë dhe i hapur për lexuesin.

(Vijon në faqen 10)

A.Tufa: Para nesh kemi një penë mjeshtërore, një rrëfimtar të lindur, që zbulon nëpërmjet humorit të zymtë, plot poezi, diavoliadën shqiptare të kaosit individual e shoqëror. Edhe pse personazhet janë thuajse të gjithë negativë, antiepikë e kontradiktorë, këta antiheronj janë përshkruar me dhimbje, përvujtni e dashuri, një karakteristikë e hershme që i dallon të gjitha krijimet e këtij autori.

Sh.Rama: Për mua personalisht ky roman përbën një kontribut të jashtëzakonshëm. Ky roman do ta zërë vendin e vet në letërsinë shqiptare. Është një roman që u mungon shqiptarëve. Është një këndvështrim që ne e kemi të nevojshëm dhe jashtëzakonisht të kohës. Po vjen në kohën e duhur dhe vjen me fuqinë e një shkrimtari që e meriton vendin e vet në pakicën e shkrimtarëve që nderon një popull.

Xh.Martini: Është një roman shumë i rëndësishëm sepse trajton disa tema shumë të rëndësishme, si p.sh.: raporti i njeriu me shtetin. Janë të rralla veprat letrare që kanë trajtuar një problem të tillë kaq të thellë edhe në gjerësi edhe në tërësi si e ka trajtuar Ramizi.
Ai është një shkrimtar popullor. Ramizi mban anën e popullit. Dhe të jesh në anën e popullit është vepra më e madhe.

A.Andoni: Romani është i ndërtuar mbi absurdin dhe krijon situata të tilla letrare dhe estetike të mahnitshme. Në raportet e individit me shtetin, mund të them se ky roman do trondisë jo vetëm letërsinë shqiptare, por edhe shtetin shqiptar.

S.Milloshi: Ramiz Gjini ka një mënyrë të shkruari shumë të veçantë.
Me lojën që ai bën me absurdin, fokuson një realitet realiteti shqiptar të kësaj epoke, i cili është memorizuar shumë mirë në kujtesën e tij.

cyan magenta yellow black

Rruga Arbërit nr. 51
kritikë

Nga Nju Jorku në Tiranë për të prezantuar veprën e tij të re, "Bibollasit". Ramiz Gjini, një penë e një stadi të ri në letërsinë shqipe, rrëfen një popull pa ndërgjegjen e elitës, një trup shumëgjymtyrësh pa kokë në postdiktaturë

Djavoliada bashkëkohore e Ramiz Gjinit


© Foto. Zaya

Një ndër virtytet e prozës së Gjinit është krijimi i skenave komike që përshkallëzohen pasforcueshëm në një të qeshur totale, gjithëpërfshirëse, e cila vjen si kundërvënie dikotomike midis së lartës dhe së ulëtës, midis frymës së qëllimit dhe praktikës banale, midis retorikës së lartë dhe fiziologjisë poshtëruese, shpirtit dhe materies etj.

(Vijon nga faqja 3)

Një ndër virtytet e prozës së Gjinit është krijimi i skenave komike që përshkallëzohen pasforcueshëm në një të qeshur totale, gjithëpërfshirëse, e cila vjen si kundërvënie dikotomike midis së lartës dhe së ulëtës, midis frymës së qëllimit dhe praktikës banale, midis retorikës së lartë dhe fiziologjisë poshtëruese, shpirtit dhe materies etj. Ligjërimi artistik hapet sipas ligjeve tradicionale me situata kinse të rëndomta dhe përfundon duke depërtuar nga shtersat objektive, në shtresa tepër të individualizuara e subjektive kohërash e situatash, në kërkim të një thelbi metafizik e irracional, në misterin e personalitetit të protagonistëve. Struktura narrative është e nginjur me një mori detajesh, përshkrimesh, peisazhesh psikologjike, ëndrrash, vegimesh, shajnish, dialogjesh e monologjesh që përimtojnë një shtresë të tretë, minimaliste e subjektive të personalitetit. Por kemi një shtresë të katërt, që përbën një ndër risitë autentike të autorit, të cilën mund ta quajmë "dimensioni okult, demonologjik", me faktorizimin e "djajve mikroskopikë", të cilët krijojnë alibi, punojnë rrengje dhe nxjerrin fate e nga binarët. Personazhët janë të dubluar në vazhdimin e projksionit të tyre nga djajtë e vegjël, të cilët, herë pas here e rrëmbejnë vetë në dorë rrjedhën e ngjarjeve. Metafizika e kësaj shtrese fantastike (e cila rëndom ka qenë një truk i veprave epike popullore), është përshkallëzuar më tej, sipas një teknike surreale, me një organizim onirik të jetëve paralele, të pavarur, pasi në sasinë e shejtallëqeve të tyre, ata ngrihen në gradë shkencore, në master dhe doktor shkencash, me komisionet vlerësuese përkatëse. Hierarkia plurale e realiteteve në roman ndërlikohet duke zbritur në rrafshe minimaliste, çka e radikalizojnë natyrën karikatureske të personazheve. Djajtë e vegjël që kanë pushtuar hapësirat hipokrite, servile e të korruptuara të Bibollit, duken madje simpatikë në rrengjet që u punojnë njerëzve. Ata i shtijnë në ngasje mendjet e njerëzve dhe krijojnë një spektakël humoristik më vete e për vete. Duket se në realitetin bibollas, edhe bëmat e djajve janë më simpatikë se ato të njerëzve. Përmasa demoniake ala faustiane e djajve mikroskopikë, që me emrat e tyre thellojnë karikaturën e thelbit të deformuar njerëzor, të kujtojnë suitën e personazheve të Djallit në romanin "Mjeshtri dhe Margarita" të Mihaill Bullgakovit dhe misionin e tyre në Moskën staliniste. Në "Mjeshtri dhe Margarita" ka një epigraf nga "Fausti" i Gëtes: "...Kush je ti fundja më në fund? Unë jam pjesë e asaj force, që tërë kohën nisem të bëj keq e që përfundoj duke bërë mirë". Edhe në romanin e Ramiz Gjinit ekuilibri i së Mirës dhe së Keqes është prishur, por djajtë ruajnë vetëm karakterin përqeshës "përtej së mirës dhe së keqes". Njeriu në romanin e Ramiz Gjinit "kapet gafil" në momentin diskret dhe atëherë pas maskës së tij, del kafsha e maskuar keq. Një vërshim i aq i fortë i kafshërores i bën një rradhë episodesh romaneske të ngjashmë me monstrat e përçudnuara në pikturat e Hieronim Boshit, duke i dhënë të përpjetë elementit surreal në vepër. Bibolli na del edhe si metaforë e qytetit të shthurur në mëkate të trashëguara, një lloj qyteti i mallkuar, i dënuar të vuajë – antiteza e qytetit të shenjtë e të bekuar, Jeruzalemit – qyteti lavire i Babilonit (gjykoni mbi ngjashmërinë Biboll – Babel – Babilon). E nëse është kështu realizmi fillestar e formal, rrëshqet pandalshëm në elemente të forta të estetikës postmoderniste, siç janë hiperteksti, autocitatet, pastishi, lojërat me kohën, përshendetjet e maskuara, parodia, fetishizmi, fragmentariteti, përmasa virtuale dhe okulte, kodimi i dyfishtë etj, të cilat përbëjnë një formacion stilistik të nginjur të lojës dhe tillit imagjinar.

IV

Nocionet dhe kategoritë kuptimore, racionale në vepër nuk arrijnë të kenë konstrukt të qëndrueshëm. Rënia, shthurja, degradimi dhe shpërfytyrimi përbëjnë një proces entropik që përfshin rrafshin individual. Metamorfoza humbet kontrollin. Mendja, në dukje e shëndoshë, pëson difekt në detaje të vogla, derisa e fut personazhin në kriza depresive. Dezintegrimi i vetëdijës merr shkak nga humbja e kontrollit mbi kujtesën. Romani hapet me një rrjedhje anormale të kohës. Ajo ecën sipas një ritmi epileptik, me konvulse, shpejtësi e bllokime të papritura. Është vetë kjo rrjedhë dhe përjetim i kohës, që nuk u jep mendjeve të Bibollit kthjelltësinë e duhur e të shëndoshë në arsyetim (personazhi i pushtetit për pak sa nuk vdes nga çmërsi i kujtesës, që nuk e lejon të gjejë mbiemrin e një prej shtëtëmbëdhjetë Filave të vdekur. Herë tjetër protagonistit nuk i kujtohet emri i djalit të tij të sapolindur dhe nëpunësi i gjendjes civile për pak sa s'e vret në kriza nervozizmi). Kujtesa si metaforë është difekti që ka pësuar "shigjeta e kohës"; ajo nuk shërben më si orientim për të lidhur kohën me hapësirën, njeriun me historinë, brezin me brez, traditën me traditë, ideologjinë me humanizmin. Qenia individuale dhe shoqërore gjendet e shkëputur nga çdo proces normal, e izoluar me ekzistencën e saj të vetmuar e në krizë.

Autori ka krijuar afreska psikopatologjike sociale plot kolorit dhe poezi absurde. Vërshojnë shembëlltyra kohërash të tjera në rrëfim, idhuj masovikë, sikundër vjen vizita e "hazretit Lenin" në kasollen e plakës Xhabie, e cila s'ka pranuar të hyjë në kooperativë, dhe grindja absurde e tyre mbi drejtësinë e ndarjes së një kokrre lajthie. Apo entuziazmi i personazhit të sapopranuar në parti, që sulet dhe përqafon njerëz, kafshë e sende, kush t'i dalë përpara... Një efekt të fortë komik që e përbashkon sociumin e Bibollit është epidemia e kruarjes. Gjatë gjithë romanit personazhet kruhen, kruajnë njëri-tjetrin sa i nxjerrin gjak. Në bazë të afërsisë apo tarafëve, krijohen grupe e sekte të mbyllura njerëzish që kruajnë njëri-tjetrin, aq sa metafizika e kruarjes themelon edhe etikën e saj, sipas së cilës rrjedh postulati: "më kruajte, të kruaj" - një tjetër zgjerim metaforik i idiomës "me u krujtë me njeni-tjetrin".

V

Gjuha e romanit "Bibollasit" është qartë, por jo e thjeshtë. Me një organizim sintaksor të rrjedhshëm ku mbizotërojnë fljalitë me periudha të shkurtëra, Gjini të ndërmend stilin e bukur klasik floberian. Thyerjet e shpeshta që ndodhin në përputhje me natyrën heterogjene të teksteve, karakteristikat tipizuese në ligjërimin e personazheve, përshkrimet dhe vërshimi i dialektit, e ngjyrosin stilistikisht miksturën e tekstit në përputhje me statusin social, prejardhjen krahinore dhe manierizmin zyrtar e profesional me bazë klishenë. Vetë shfrytëzimi i klisheve dhe idiomave përbën një humus eksperimental për efektin komik të veprës. Një ndër personazhet që mishëron incestin frymor të diktaturuës dhe postdiktaturës, ish-sekretari i partisë në brigadën e madhe të plehut, tani *i bekuari* hoxhë Rrahimi, ruan këtë pleksje të shartuar ligjërimi, me të cilën u drejtohet gjatë gjithë romanit njerëzve në minutat e tyre kritike për jetën: "*Selam alejkum! Salvatet dhe përshëndetjet tona, qofshin mbi shokun tonë të dashur, Muhametin alejhi selam, mbi familjen, shokët e organizatës dhe mbi ata, që e ndjekin këtë rrugë deri në ditët e kiametit. Një melek agjent, që punon për ne, më raportoi, që ti more i shkretë, e lave borxhin. Megjithatë, Allahu, udhëheqësi ynë i lavdishëm, e di më së miri*". Është pikërisht ky personazh, të cilit shejtani Ibilis e lakmon më shumë, për kënaqësinë që do t'i japë duke e torturuar.

VI

Romani "Bibollasit" nuk ka personazhë klasikë pozitivë. Personazhet të gjithë janë një shumë katastrofash të personalitetit, që nga bracët e vegjël, zyrtarët, të huajtë, politikanët, gratë, artistët e shkrimtarët e deri tek djajtë e vegjël. Në roman lëvizin në një rrjedhë të pleksur njerëz e djaj. Kemi vetëm një engjëll dhe ky është engjëlli Azrail, që vjen për të marrë shpirtërat. Në fund të romanit ai vjen i maskuar si hidraulik në apartamentit e shkrimtarit Nurçe Tarrota, të cilit ia nxjerr shpirtin me tel nga hunda, e vetëm pasi e hedh në shishkë kupton se ka gabuar, duke e ngatërruar me një tjetër, por engjëlli i vdekjes nuk e vret mendjen. Në këtë skenë kemi takimin dhe bisedën e tij me kryeshejtanin Ibilis, me të cilin hahen për shitjen e shpirtrave. Djalli Ibilis kërkon t'i blejë engjëllit Azrail disa shpirtra të zgjedhur, por ata hahen për çmimin. Pikërisht në këtë skenë kemi një pasazh të mrekullueshëm autoironik:

"*...Shejtani Ibilis deshi t'ia mbushte mendjen engjëllit Azrail t'i krijonte mundësinë, që të blinte shpirtin e autorit të këtyre rradhëve, por engjëlli Azrail i tha: vetëm atë shpirt mos ma kërko, sepse nuk mund ta shes kurrën e kurrës. E kam parë se si, teksa shkruan, digjet me flakë të zjarrta si ari, pa kurrëfarë tymi. Kam urdhër prej vetë Zotit, që kur ta marr, ta dërgoj se s'bën drejt e në parajsë*".

Nga gjithë kjo diavoliadë që parakalon nëpër 407 faqe të romanit, ia vlen, edhe pse me humor, të mbrohesh nga energjia gjuhësore e botës së krijuar, nga kjo "bombë" artistike në miniaturë. Dhe sigurisht, edhe lexuesi do ta miratojë heshturazi me kokë, të vetmen bindje të padiskutueshme të engjëllit Azrail.

ANDON ANDONI: Një roman që do trondisë letërsinë shqipe

(Vijon nga faqja 9)

Ai është një gjuhë dhe një mori personazhesh më shumë se të përditësuar: policë, tregëtarë, bashkiakë, gra të papuna, shkrimtarë etj, por tejet të thjeshtës deri në vulg, si Haruni i biznesit të WC, Zavi, Aqif Qirës etj. Romani fillon si një bashkëbisedim që në fakt është dhe kredo e romanit: përmbysja e një bote të vjetër në Biboll dhe ngritja e një botë të re porse me huqe për shkak se nuk u bë mirë, pasi u ngrit nga të njëjtët ustallarë dallkaukë e rrufjanë që patën ngritur të vjetrën... Dhe kjo bisedë, rrjedh mes personazhesh që përtypin farat e luledielli në një tas të mbushur plot mbi tavolinë...

Pak a shumë rrjedha e narracionit të fut në një situatë që do të jetë si e tillë, e ngritur mbi perversitete të një jete mëse të rëndomtë dhe tejet të shtrirë e të zvargur deri në kotësi.

Aq sa lexuesi nëpërkëmbet në dilemat, jo më te një komuniteti, të hedhur në kotësi, porse të një sjelljeje qytetare pezhorative me pikëpyetjen e madhe të njohur në këtë vend prej dekadash si: "A mund të bëhet ky vend me njerëz e katandi si e gjithë bota?"

Në letërsi përdorja e të pavërtetave për reale është mëse e pranueshme që nga detajet e përzënijes së mizave nga Zav Tarrota e deri tek makabritete e kruarjes kolektive të njerëzve, shitja e titujve dhe diplomave etj. Ato vijë e marrin besueshmërinë e leximit artistik, siç thote Eko. Ngaqë ngadalësimi mbi të parëndësishmen dhe nxitimi mbi të jashzakonshmen apo thelbësoren janë ato që e bëjnë romanin me një dramaticitet të fuqishëm.

Vini re: kur lexuesi pret orë e çast të mësojë se ç'bëhet me Žavin e betonuar, letrarja na kalamend për faqe të tëra me radhë me tregun e të panginjurit Kroq Murdarit.

Duke marrë peshën e metaforave dhe simboleve, madje tërë romani është një simbolikë e thekur për jetë njerëzore të shkuara kot, për botën e huaj që të merr, apo të ble edhe kufomën, kur nuk je i zoti të bësh më të mirën për të ringritur shtet e milet, janë zemreku i romanit dhe tharmi që e shtyn atë përpara.

Ç'vlerë ka libri për lexuesin e kualifikuar? Pa dyshim është një letërsi që siç thashë e trondit botën letrare dhe atë intelektuale. Madje, edhe lexuesin e thjeshtë nëse do jetë i duruar, si modeli i Zav Tarrotës dhe Lulushes, porse druaj se do ta trondiste edhe botën e pushtetit, më shumë cinike se sa vetë mënyra e shkrimit të tij, se sa për rininë e këtij vendi, për të cilët kam shpresë që ky libër t'i mbetet në duar. Madje, një gjë të tillë kemi filluar ta bëjmë edhe ne, të parët që porsa e kemi lëshuar nga duart "Bibollasin" e Ramiz Gjinit, nëpër tavolinat e kafeneve, por jo me fara luledielli, duke pyetur natyrshëm: - a ka shpresë. Shpresë për të përmbysur jo më një njeri apo disa personazhe në zhul dhe mërzi të thellë, të gjendura në letraren e kësaj proze, porse një mentalitet të tërë shoqëror, që ka kthyer sytë nga qytetërimi i munguar dhe i synuar prej një kohe shumë të largët, madje shekullore.

Kumtesë në Konferencën Përkujtimore': 'Nënë Tereza në 100-Vjetorin e Lindjes', organizuar nga Ministria e Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve, nën kujdesin e Kryeministrit Sali Berisha

Nënë Tereza: Një jetë në shërbim të njerëzimit



Dr. **GËZIM ALPION**
Universiti i Birminghamit, Angli

Për mua është gjithmonë kënaqësi të flas për Nënë Terezën dhe të takohem dhe bisedoj me studiues, admirues, dhe e pse jo, edhe me kundërshtarë të Nënë Terezës. Ballafaqimi i mendimeve në mënyrë të kulturuar është mënyra më e mirë për të respektuar kujtimin e Nënë Terezës, për të analizuar në mënyrë të paanshme rëndësinë e saj si figurë publike universale shumë planëshe, dhe për të vlerësuar sa më objektivisht kontributin e saj pothuajse të pashoq si personalitet fetar, ikonë e Katolicizmit dhe mediave në post-modernizëm dhe mbrojtëse e përkushtuar e jetës dhe dinjitetit të njeriut.


Si sociolog unë jam i interesuar kryesisht në tre tema – autorësinë, besimin fetar dhe nacionalizmin – duke u përqëndruar respektivisht në shkrimtarin anglez D. H. Lawrence (1885-1930), Nënë Terezën (1910-1997) dhe, më së fundi, Faik Konicën (1875-1942). Të tre këta personalitete iu përkushtuan tre idealeve që në pamjen e parë duket sikur nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me njëri tjetrin. Lawrence shkroi më shumë për 'dashurinë', veçanërisht për forcën emancipuese të seksit, që nuk duhet ngatërruar me 'eroticizmin banal'; në një letër ai i referohet vetes së tij si 'prifti i dashurisë'. Nënë Tereza iu përkushtua Krishtit, dhe këtë përkushtim e manifestoi në dashurinë e saj jo me fjalë por 'duke vepruar', siç thotë admiruesi i saj anglez, Malcolm Muggeridge (1903-1990). Ndërsa Faik Konica, megjithëse nuk ishte fetar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, ngadhnjeu si prifti i ndërgjegjes kombëtare, dhe devotshmëria e tij ndaj kombit nuk duhet shikuar nga një kënd i ngushtë patriotizmi folklorik por në kuadrin e përpjekjeve të tij për të ndërgjegjësuar një komb të vogël si i yni për domosdoshmërinë e përpjekjeve të organizuara për të mundësuar një afirmim dinjitoz vlerash kombëtare në një kohë kur ekzistenca jonë si komb ishte në pikëpyetje.

Pavarësisht nga dhuntitë me të cilat lindin apo profesionet që zgjedhin, njerëzit e mëdhenj janë para së gjithash të dashuruar me njerëzimin; ata janë të përkushtuar në përpjekjet e tyre për të mbrojtuar dinjitetin njerëzor të cilin e konsiderojnë të shenjtë. Kjo është thelbësore në jetën dhe aktivitetin e Lawrenceit dhe Konicës, por veçanërisht në rastin e Nënë Terezës, e cila gjeti në humanizmin e shenjtëruar të Krishtit një provë të padiskutueshme, siç e shikonte ajo, të dashurisë së Zotit për njeriun, për çdo njeri, të varfër apo të pasur, të aftë apo me kufizime shëndetësore, të çdo lloj race, ngjyre, kombi, etniciteti apo feje.

Kundërshtarët e Nënë Terezës, për arsye të ndryshme, të cilat sot nuk kemi kohë t'i përmendim të gjitha e jo më t'i shtjellojmë në detaje, nuk janë dakord me publicitetin pozitiv që iu rezervua Nënë Terezës, kësaj figure qëndrore të Katolicizmit modern, veçanërisht pas akordimit të Çmimit Nobel për Paqen në 1979, në një kohë kur ajo, sipas tyre, nuk bëri ndonjë gjë me peshë për të zhdukur varfërinë apo për të kritikuar shfrytëzimin kapitalist.

Nënë Tereza nuk tha asnjëherë se ajo dëshironte apo se u përpoq që ta ndryshonte botën vetë, apo bashkë me motrat, vëllezërit dhe përkrahësit e urdhërit të saj 'Motrat e Bamirësisë', të cilin e krijoi në 1950. Disa artistë në Perëndim si Bob Geldof dhe Bono janë përpjekur dhe vazhdojnë të përpiqen por akoma nuk ia kanë arritur qëllimit të tyre sa fisnik aq edhe naiv që ta bëjnë varfërinë e botës diçka që i përket historisë. Nënë Tereza e kuptonte më mirë se Geldof dhe Bono se kjo botë është shumë e ndërlikuar për ta rregulluar menjëherë. Gjë që nuk e bëri Nënë Terezën të qëndronte në vend apo të priste që bota të ndreqej vetë apo ta ndreqnin të tjerët. Megjithë përkushtimin e saj për të ndryshuar botën, Nënë Tereza ishte gjithmonë realiste se c'mund të bënte ajo, dhe anëtarët dhe përkrahësit e urdhërit të saj në Kalkuta dhe në botë.

> Njerëzit, kudo që ndodhen në botë, gjejnë diçka me vlerë tek Nënë Tereza. Ndërsa unë si studiues e vlerësoj Nënë Terezën përveçse për vizionin dhe shpirtin e saj revolucionar, veçanërisht për integritetin e saj profesional, edhe për përkushtimin me të cilën i sherbeu Krishtit, përkushtim që kërkoi sakrifica të shumta jo vetëm në aspektin e privimeve për një jetë 'normale' por edhe të sprovave të mëdha të shpirtit që përjetoi ajo të paktën që nga viti 1940, sprova që nuk e bënë asnjëherë të humbiste besimin se jeta e njeriut, e çdo njeriu, si figura e Krishtit, janë shenjtërisht të binjakëzuara.



Vetë Nënë Tereza, më se një herë, është shprehur se kontributi i saj ka vlerë sa 'një pikë uji në oqean', gjë që dëshmon jo vetëm për modestinë e saj po edhe se sa mirë e dinte se ç'mal duhet të ngjisë njerëzimi për të zgjidhur problemin e varfërisë dhe padrejtësitë sociale një herë e përgjithmonë.

Nënë Tereza nuk ishte revolucionare në kuptimin e mirëfilltë politik të fjalës, por kishte shpirt revolucionar. Rëndësia e kontributit të saj qëndron jo në statistikat që publikohen për numrin e shtëpive të urdhërit të 'Motrave të Bamirësisë' nëpër botë, apo në numrin e jetimoreve, apo qendrave të ndryshme. Kjo nuk do të thotë që këto statistika nuk duhen vlerësuar. Unë vetë kam patur rastin të shikoj në Kajro, por veçanërisht në Kalkuta, se si motrat dhe vëllezërit e Nënë Terezës kujdesen për të moshuarit që janë hedhur në rrugë nga të afërmit dhe shoqëria, për fëmijët ilegjitim, jetim apo me të meta mendore, për gratë që vuajnë nga dhuna në familje apo për viktimat e SIDËS dhe sëmundjeve të tjera me stigmë shoqërore.

Disa gazetarë perëndimore si Christopher Hitchens e sulmojnë pa reshtur Nënë Terezën. Në disa raste këto sulme bëhen me një gjuhë dhe tone vulgare. Një vulgaritet të tillë kundërshtarët e 'principtë' të Nënë Terezës nuk do të kishin guxuar ta përdornin ndaj personaliteteve të tjera të shquara, veçanërisht ndaj ndonjë personaliteti kulturor apo politik me famë botërore, pasi këta të fundit pa dyshim do t'i kishin paditur me sukses duke u kërkuar dëmshpërblime për akuza dhe shpifje banale. Hitchens le ta provoj t'iu shërbejnë të varfërve të Kalkutës jo për afro 70 vjet, siç bëri Nënë Tereza, por një vit ose disa muaj, për të mos thënë edhe një javë të vetme, për ta provuar se sa e lehtë është t'i privosh vetes një jetë normale për hir të një ideali ku përkushtimi ndaj dinjitetit të njeriut është parësor.

Ndërsa akademikja feministe australiane Germaine Greer, e cila e quan Nënë Terezën një 'fetare imperialiste', çuditërisht nuk është në gjëndje të shikojë se sa figurë emancipuese është Nënë Tereza, veçanërisht po të kemi parasysh se me sa kurajo dhe vendosmëri ajo kërkoi që vizioni i saj të dëgjohej dhe aprovohej nga Kisha në Kalkuta, Indi dhe vetë Vatikani, të cilët vazhdojnë të mbeten në thelb insitucione patriarkale.

Për sa u përket intelektualëve Indian si Aroup Chatterjee, Krishna Dutta dhe Dhiru Shah, të cilët e akuzojnë Nënë Terezën si shkaktare për imazhin negativ të Kalkutës dhe Indisë në botë, ata duhet të kenë me tepër kurajo që të mos shikojnë çdo të huaj, veçanërisht një personalitet fetar bamirës si Nënë Tereza, vetëm me zyzet e një ndjenje të fyer kombëtare post-kolonialiste. Nënë Tereza nuk shkoi në Indi fillimisht në vitin 1929 si pjesë e arsenalit kolonialist perëndimor. Nënë Tereza shkoi në Indi në kërkim të Krishtit të cilin e gjeti gjithmonë tek njerëzit, veçanërisht njerëzit e paprivilegjuar, njerëzit që trajtoheshin dhe trajtohen si 'plehra' nga shoqëria njerëzore.

Është e vërtet që mediat perëndimore nuk reshtën së renduri drejt Kalkutës sa ishte gjallë Nënë Tereza dhe kur u nda nga jeta, dhe në këtë proces Kalkuta u bë, deri diku, simbol i varfërisë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Nënë Tereza e 'shpiku' apo e 'propogandoi' varfërinë e Kalkutës. Për më tepër, ajo nuk foli asnjëherë për varfërinë e Kalkutës me terma ekskluziv. Kalkuta, ky qyteti i dikurshëm imperial, mjerisht, ka kohë që është shndërruar në një mega metropol varfëria dhe mjerimi i të cilit bien në sy menjëherë.

Intelektualët Indian që vuajnë, deri diku në mënyre të ligjshme, kur shikojnë se vendi i tyre i bukur përmendet në Perëndim vetëm për varfëri dhe uri, duhet të jenë më objektiv dhe zemërgjerë kur analizojnë kontributin që dha Nënë Tereza në Indinë e pas pavarësisë. Për fat të mirë, një nga themeluesit e Indisë moderne, Kryeministri Jawaharlal Nehru, dhe udhëheqës të tjerë Indianë të feve të ndryshme si dhe në shtetin e Bengalit Perëdimor, ditën t'a vlerësojnë jo vetëm përkushtimin vetjak të Nënë Terezës për t'u shërbyer të varfërve të Kalkutës por në të njëjtën kohë edhe guximin dhe shembullin e saj për të sfiduar disa tabu te vjetra, ndër të cilat duhet veçuar komunikimi i saj i drejtëpërdrejtë me njerëzit e kastave të ulta që akoma shikohen me përbuzje në Indi. Nënë Tereza ua bëri më të lehtë barrën politikanëve dhe qeverive Indiane për të prezantuar dhe zbatuar reformat e tyre progresiste që synonin përmirësimin e kushteve të e jetesës për kastat e përçmuara Indiane.

Nënë Tereza u bë një shembull i madh frymëzimi si për politikanët e tipit të ri të Indisë së pavarur ashtu edhe për miliona njerëz të thjeshtë në Perëndim. Nënë Tereza është shprehur disa herë se kur filloi të vizitojë Perëndimin për herë të parë në fillim të viteve 1960-të, ajo gjeti atje një lloj varfërie që, sipas saj, është edhe më e rëndë se varfëria materiale. Ky konkluzion i kësaj murgeshe të zgjuar dhe të përkushtuar shqiptare ishte një thirrje për Perëndimin për të rishikuar përparësitë dhe për të mos matur vlerën e gjithçkaje vetëm nga ana monetare.

Njerëzit, kudo që ndodhen në botë, gjejnë diçka me vlerë tek Nënë Tereza. Ndërsa unë si studiues e vlerësoj Nënë Terezën përveçse për vizionin dhe shpirtin e saj revolucionar, veçanërisht për integritetin e saj profesional, edhe për përkushtimin me të cilën i sherbeu Krishtit, përkushtim që kërkoi sakrifica të shumta jo vetëm në aspektin e privimeve për një jetë 'normale' por edhe të sprovave të mëdha të shpirtit që përjetoi ajo të paktën që nga viti 1940, sprova që nuk e bënë asnjëherë të humbiste besimin se jeta e njeriut, e çdo njeriu, si figura e Krishtit, janë shenjtërisht të binjakëzuara.

Email: g.i.alpion@bham.ac.uk

Rruga Arbërit nr. 51
kujtesë

Busti është realizuar në bronx nga skulptori i njohur Ramadan Kanxha, me mbështetjen financiare të stërnipërve të Mersim Demës, Sadi e Ali Xhevat Dema

Shupenzë, përurohet busti i atdhetarit Mersim Dema

Nga: **HYSEN LIKDISHA**





E martë, 27 korrik 2010. Ka qenë kjo një ditë krejt e veçantë për banorët e komunës së Shupenzës, në rrethin e Bulqizës. Që në orët e para të mëngjesit, qindra e qindra banorë të kësaj komune dhe zonave përreth, u tubuan në Shupenzë, për të marrë pjesë në përurimin e vendosjes së bustit të atdhetarit të kësaj zone, Mersim Dema.

Lindur më 1864 në njërën prej familjeve të Ish fisit të madh e të njohur të Demajve, në fshatin Homesh të komunës Shupenzë, Mersim Dema gjithë jetën e tij punoi e luftoi për atdheun, si një udhëheqës i shquar i forcave kryengritëse popullore dibrane. Ja si e portretizojnë patriotin Mersim Dema, tregimtarët gojorë: "Mersim Dema, në kohën kur jetoi e veproi ka ecur me pushkë në krah dhe abetare nën sqetull me parullën "Liri a vdekje". I përkushtuar në riorganizimin e kuvendeve tradicionale të Maleve të Dibrës, që kurrë nuk e njohën pushtetin osman, por i rregulluan marrëdhëniet shoqërore mes tyre sipas të drejtave zakonore, Mersim Dema u cilësua për kohën që jetoi e punoi si "Mbreti i Maleve". E përmbledhur në substancë, veprimtaria atdhetare e këtij patrioti të madh spikat për luftën kundër Turqisë Osmane dhe monarkive ballkanike që rendnin ta copëtonin vendin tonë.

Princi gjerman Vilhelm Vidi, i ardhur nga Fuqitë e Mëdha në fronin e Shqipërisë më 7 Mars 1914, në një takim që ka zhvilluar në Durrës me krerët më në zë të Shqipërisë, në korrik të 1914, ku ka marrë pjesë edhe Mersim Dema, si përfaqësues i Dibrës. Në një audiencë të veçantë që rezervuan me këtë rast Princi dhe Princesha, për Mersim Demën, pasi janë njohur me veprimtarinë e tij, Vidi i është drejtuar Mersimit me fjalët: - "Unë jam Princi i Shqipërisë, por "Princi i Dibrës" qenke ti".

Kështu, komuniteti i Grykës së Vogël, por jo vetëm e kanë pritur me padurim e krenari të ligjshme ditën e martë 27 korrik 2010, të përurimit të bustit të atdhetarit Mersim Dema, vendosur në Shupenzë qendër e kësaj komune dhe krejt Grykës së Vogël.

"Ndoshta jemi pak vonë, në nderimin e kësaj figure, shprehen banorë të shumtë të ardhur në këtë promovim, por mirë u bë, pasi një fjalë e urtë thotë; "më mirë vonë se kurrë". Ka qenë në fillim një interesim personal i pinjollëve të fisit Dema dhe konkretisht i stërnipërve të Mersim Demës, Sadi e Ali Dema, që është përkrahur edhe nga kryetari i komunës Shupenzë, Moisi Llani, që ka inicuar vlerësimin e figurës së këtij personaliteti që punoi e luftoi gjithë jetën e tij në dobi të atdheut. Ndërkohë edhe këshilli komunal i komunës Shupenzë, ka marrë unanimisht vendimin për vendosjen e bustit të Mersim Demës aty ku i takon, në qendër të komunës Shupenzë. Ndihmuan dhe sponsorizuan në realizimin e bustit, veç komunës Shupenzë edhe Ali e Sadi Dema, djemtë e Xhevat Demës, nipit të Mersim Demës, i cili para se të ndërronte jetë më 11 shtator të 2003 nga një infarkt i miokardit, u kishte thënë shpesh dy djemve se "Gjyshi (Mersim Dema) ka qenë historia e gjallë e Dibrës".

Kjo thënie, tregon Sadiu, njëri nga djemtë e Xhevatit që ka ardhur nga Lushnja ku banon aktualisht për të marrë pjesë në ceremoninë e përurimit të bustit, mua dhe vëllait tim, Aliut që banon në SHBA, na ka shoqëruar vazhdimisht, si amanet i babait tonë për tu realizuar, gjë që po ndodh sot, e përfundon fjalën e tij plot emocion, Sadiu.

Morën pjesë në këtë ceremoni përurimi, përveç qindra banorëve të zonës edhe Nënprefekti i Bulqizës, Hamit Dervishi, kryetari i Bashkisë Peshkopi, Ilir Krosi, përfaqësues të komunave fqinje, Gjoricë, Zerqan, Fush-Bulqizë etj, si dhe drejtoresha e Zyrës Arsimore Bulqizë, zonja Miranda Kurti.

Gjithashtu nderoi me pjesmarrjen e tij edhe kryetari i komunës të Dibrës së Madhe në Maqedoni, Argëtim Fida.

Tubimin e organizuar me këtë rast e hapi kryetari i komunës Shupenzë, Mois Llani, i cili pasi përshëndeti pjesëmarrësit e shumtë në këtë tubim, në fjalën e tij vlerësoi lart figurën e patriotit Mersim Dema. Nderimi që i behet sot Mersim Demes, tha me tej në fjalën e tij kryekomunari i Shupenzes, është nderim për të gjithë komunitetin tonë, pasi gjithë jetën e tij punoi e luftoi për liri e pavarësi të atdheut.

Në vijim morën fjalën për të përshëndetur historiani Moisi Murra, autori i librit monografik "Mersim Dema, Mbreti i Maleve", kryetari i këshillit të komunës Shupenzë, Flamur Jani, përfaqësues të familjeve të njohura në miqësi me atë të Demajve si ajo e Markjeve në Zogje dhe Hoxhajve të Muhurrit. Menduh Dema, i cili, tejet i emocionuar në fjalën e tij përshëndetëse pasi përmendi disa nga bëmat e Mersim



Demës në dobi të Atdheut tha se: "Për tu bindur në lidhje me madhështinë e figurës së Mersim Demës, mjafton të citojmë se si janë shprehur për të figura të njohura historike të kohës si, Princ Vidi dhe kryeministrin serb Pashiq; -ku i pari e ka quajtur Mersim Demën; "Mbreti I Maleve" dhe i dyti, "Princi që nuk po na bindet". Ndërkohë, veprimtaria patriotike e Mersim Demës, tha në vijim të fjalës së tij, Menduh Dema, është vlerësuar edhe ish Presidenti Sali Berisha që më 14 nëntor 1992, i dha pas vdekjes "Urdhërin për veprimtari patriotike të klasit të parë".

Përshëndetën gjithashtu edhe stërnipi i Mersim Demës, pjesmarrës në këtë tubim, Sadi Dema, kryetari i Bashkisë Peshkopi, Ilir Krosi dhe kryetari i komunës së Dibrës së Madhe në Maqedoni, Argëtim Fida. Ndërkohë, mjaft pjesëmarrës në këtë ceremoni të përurimit të bustit të patriotit Mersim Dema, vlerësuan veprimtarinë e tij në dobi të atdheut, të cilët vendosjen e bustit më shumë se nderim për të e cilësuan si nderim për gjithë Grykën e Vogël e zonat përreth saj, Dibrën dhe më gjërë. Më pas para të pranishmëve të shumtë, mes durtrokitjeve u zbulua busti i Mersim Demës, i realizuar në Bronx, nga skulptori i njohur Ramadan Kanxha,il cili mori mjaft përshëndetje si nga pjestarë të fisit Dema, ashtu edhe nga pjesëmarrësit e shumtë, për realizimin artistik dhe me mjaft dashuri të kësaj vepre skulpturore e vendosur tashmë krejt madhështi aty ku dhe i takon, në qendrën e komunës Shupenzë dhe krejt Grykës së Vogël.

merr kopjen tënde

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Tel. 069 20 68 603 / 068 31 19 232
www.**rrugaearberit**.com

Redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit", në bashkëpunim me një gazetë të përditshme shumë të njohur, kërkojnë një korrespondent për qytetin e Peshkopisë.
Të interesuarit të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.
Faleminderit!

emigracion

Brenga dhe drita që i vjen Idriz Bucit


Idriz Buci

Idrizi e kishte një brengë, nga ato lloj brengash që të këpusin krahun, të ndalojnë hapin e të zhubravisin shpirtin siç zhubravitet një letër ëndrrash të këputura nën mengenenë e grushtit që shtrëngohet fort.

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Më mori në telefon. Më tha se quhet Idriz Buci. Më përmendi Lurën çka më bëri që ta lë paksa mangët për atë ditë punën në kopshtin ku punoja dhe të nxitoja ta takoja. Të udhëtoja mes kujtimesh, atyre vendeve që të ngrenë peshë e të marrin fluturim për të të vënë në sy pamje që të shtojnë jetën e të ngjisin në buzë gazin. Kështu më ndodh kur dikush më përmend Lurën, liqenet e Kacnisë, masivin e bjeshkëve të Korabit, Kallkanin, luginën e Drinit, kanionin e Gjalicave me Setën nëpër këmbë...


Ermal Buci

Atje brodha në rininë dhe burrërinë e jetës sime...

U ulëm dhe porositëm nga një kafe. Idrizin e kisha takuar kohë më parë. Kishim shkëmbyer pak fjalë e kishim lidhë nyje adresat telefonike. Asokohe më kishte thënë se ishte inxhinier elektrik, se kishte punuar pesë vjet në Peshkopi ato kohe kur Dibra, mbi kanalet ujitëse ngrinte hidrocentrale të vegjël fuqia e të cilëve, po ti hiqje minierën e Bulqizës, mjaftonte për dritë për të gjithë rrethin. Asokohe kur inxhinierët elektrikë dhe hidroteknikë dibranë projektonin që me shfrytëzimin e plotë të rënies së lirë të ujit në kanalet malorë ujitës të prodhonin aq kilovat - orë sa e gjithë treva të ngrohej e gatuante me energji elektrike...

Idrizi e kishte një brengë, nga ato lloj brengash që të këpusin krahun, të ndalojnë hapin e të zhubravisin shpirtin siç zhubravitet një letër ëndrrash të këputura nën mengenenë e grushtit që shtrëngohet fort.

Ermalin nuk e kishte më. Kishte ikur për të mos u kthyer kurrë. Kishte ardhur në Greqi në vitin 1997. Nuk kishte ardhur për "bukën e gojës", se me ato që merrte ai dhe gruaja e tij, jetonte mirë. Kishte ardhur se e ndjente se pas atij viti të mbrapshtë do të ishte e vështirë për fëmijët. Donte që ata të ecnin në rrugë të tjera, më të gjëra, më me dritë, me të ardhmen pranë. Erdhi për fëmijët, siç erdhën shumë shqiptarë që koha që nisi me krisma e shkatërrime ua zhvokshi përfytyrimin.

Ermali filloi shkollën. Në Shqipëri kishte mbaruar klasën e gjashtë. E nisi si përgatitor në gjuhën greke por, vetëm pak ditë më vonë i thanë se mund të vazhdonte lirisht klasën e parë të gjimnazit. Do të ishte më i miri në gjimnaz. Do të ishte më i miri në lice. Do ta kërkonin për pedagog në universitetin ku u diplomua për informatikë mjekësore. Nuk pranoi. E donte profesionin e tij me shpirt ndaj, para se të ngjitej në katedrën e pedagogut, deshte të hynte në labirintet e praktikës. Filloi punën si specialist i thjeshtë. Një ditë pronari i vu përpara një aparat që kushtonte tetëdhjetë mijë euro, aparat që askush nuk kishte guxuar të hynte paneleve e skemave të tij marramendëse. E rregulloi duke ngjallë habi, smirë por edhe respekt. Pronari atë ditë i komunikoj se e emëronte drejtor...

I shoqëruesh ëm, mik me të gjithë, i kudogjendshëm kur dikush e thërriste për të rregulluar një kompjuter apo për të futur një program...

Nuk kishte makinë. Kishte një motoçikletë të vogël, një "papaq" siç i thonë. Kurrë nuk abuzoi në shpejtësi, kurrë nuk theu rregullat e qarkullimit rrugor. E keqja, fatalja do ti vinte një ditë nga ai soj të rinjsh që hyjnë mes njerëzve mbi një rrotë, mbi motorë të fuqishëm që të tronditin me krismat e tymnxjerrëses si të ishin krisma mitralozi të rëndë. Një nga ata, në shpejtësinë marramendëse, ra mbi Ermalin duke ia marrë jetën...

"Ishin shtatë grekë në garë, me një shpejtësi treqind e njëzet kilometra në orë, tregon Idrizi. Sipas filmimit që e ka policia, unë nuk e shoh por e kanë parë të tjerët, motori tre metra para goditjes personi është shkëputur dhe ka goditur çunin... Njëmbëdhjetë vjet kishte që e përdorte motorin, një gërvishtje nuk kishte mbi të."

...E kishte një hall miku im nga Lura Idriz Buci, një hall që, si i thonë në vendlindje të tij, mos e pastë hasmi.

Këtu nisëm një bisedë si në kullat e Lurës, si në normat e "Karareve të Dheut", siç i thonë atje. Se, si thonë, e "Keqja i ra drurit dhe e thau, i ra gurit dhe e çau, i ra burrit dhe e mbau..".

Idrizi mbahej, megjithëse nga dhimbja kishte një vit që e kishte lënë punën. Nuk i ka mbushur ende të gjashtëdhjetat. Ka përvojën e madhe të njeriut të shkollës dhe punës shqiptare.

Idrizi është rrënjë ikur prej afro një gjysmë shekulli nga Bucet e Fushë Lurës, "Bucet e Nezirit" siç thotë duke përmendur një njeri "derëhapur në të dy kanatet" për këdo që vinte në Fushë Lurë. Se Buce nuk ka vetëm në Fushë Lurë, ka edhe në fshatrat e tjerë të Lurës, ka edhe në fshatra të tjerë të Dibrës, ka thuajse në të "Nëntë malet"e saj.

E zgjerojmë kuadrin e jetës së tij, jetë në Tiranë, jetë në Peshkopi, jetë në Greqi.

Ka mbaruar për inxhinieri elektrike në vitin 1977. "Në se të kujtohet, më thotë, jemi takuar në Peshkopi (asokohe unë isha gazetar i ATSH-së) ku kam ndejë pesë vjet. Kam punuar me Përparim Zhulalin e me Bardhok Rajtën, në repartin elektrik, sipër farmacisë..."

Dhe, për një çast, në sytë e tij lexoj mall tek përmend Hajri Shehun në zyrën e llogaritarit në ndërmarrjen elektrike të Dibrës, Lutfi Grevën, Ismail Camin, Islam Shehun një specialist dhe njeri shumë i mirë, Shaban Spahiun...

Në Peshkopi punova si kryetar i degës elektrike për fshatin, punë e cila më bëri ta njoh dhe ta dua me shpirt Dibrën.

Biseda zbret nëpër kanale me ujë dhe hidrocentrale të vegjël kur më thotë se në gazetën "Ushtima e maleve" kishte bërë një artikull me titull "Shfrytëzimi i burimeve ujore faktor me rëndësi për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike".

I them se për mua është një temë e njohur, temë në një shkrim të gjatë "Po mbytet Dibra, ku janë dibranët?", botuar në gazetën "Rruga e Arbrit" dhe disa gazeta të tjera. Shkurt thosha se me Skavicën do të mbytet historia e Dibrës por me ndërtimin e hidrocentraleve të mesëm mbi degët e Drinit të Zi si Veleshica, Malla, Seta, Murra, Zalli i Okshtunit etj. do të kishim jo vetëm dritë, jo vetëm furnizim pa ndërprerje me ujë gati sa ai i hurdhës së Skavicës për hidrocentralet e tjerë në kaskadën e Drinit, por edhe për turizmin të lidhur me Liqenet e Lurës, Liqenet e Kacnisë, masivin e bjeshkëve të Korabit etj. bukuritë e të cilëve janë të virgjëra.

Këtu ndalemi dhe biseda udhëton në të dy zërat, larg, në ato vende ku ai si specialist i njeh mirë dhe ka punuar që ato vende të prodhojnë dritë.

Nuk duhet të mbytet Dibra, më thotë, nuk ka leverdi, nuk jep dritë Skavica, dritë japin hidrocentralet e vegjël dhe të mesëm mbi të gjithë Dibrën.

Psherëtin shoqëruar me atë shprehjen karakteristike dibrane të njeriut kur i duket vetja ngushtë "Ah! Oj nanë"!

Ikim nga Dibra për tu ndalur për vite të tëra në Tiranë, në Institutin e Projektimeve Elektrike, në Ndërmarrjen e Veshjeve...

Pastaj vijmë në Greqi. "Unë isha mbret në Tiranë. Me gruan, ekonomiste e lartë, merrja dy milionë e gjysmë lekë të vjetra në muaj. Ika për hirë të kalamajve, që të mos mi marrë në qafë çoroditja shqiptare e armëve që në vitin 1997 ishin nëpër duar.

Në Greqi kisha vëllanë, Fehmi Buci, mjeshtër në ndërtime, mjeshtër në ngritjen e çative. Ka licencë, merr punë vetë. Ka punuar në minierën e Bulqizës e më vonë atë të Valiasit.

U futa drejtpërdrejt në zanat, në montime panelesh. Lodhje ka por nuk është si në beton e llaç. Kur kam punuar tek "Hilton", në rikonstruksionin e tij prej 64 miliard dhrahmi në atë kohë, u habit pronari, Andoni Karabjas. Thoshte: "Ku i di ti lidhjen e këtyre qindra e mijëra fijeve. I them "Unë jam inxhinier si puna juaj pavarësisht se ju nuk ma njihni. Kam punuar me literaturë shkencore të kohës.

Dhe vazhdon: Shkolla shqiptare dije teorike dhe punë praktike e asaj kohe nuk vjen më në Shqipëri. Këtë harroje."

..Kthehemi përsëri tek "plaga" e tij, tek Ermali. Nuk donë t'i largohet. E pyes, paksa për ta larguar, në se ka fëmijë të tjerë.

Më thotë se ka një djalë, "Profesor baleti. Ka fituar katër herë vend të parë në Greqi. Ka fituar edhe në Itali, Shkup, në Gjermani. Bëri këtu shkollën e baletit. Kryesisht merret me baletin latin, jo klasik...

Këtu, shiriti i magnetofonit kishte arritur fundin e xhirimit.

Biseda jonë do të kthehej përsëri në Dibër, do të ulej në odën e saj cilësuar si universitet popullor e do të komunikonte me njerëz në adresa malesh e me emër të përveçëm.

Kur u ndamë ndjeva një brengëzbutje të tij, një dritë që ishte fokusuar në të ardhmen.

Dje më mori në telefon. Do të takohemi përsëri. Do të takohem edhe me të birin e tij balerin. Do të takohem edhe me të vëllanë, mjeshtër duarartë në ndërtim.

Athinë, 1 dhjetor 2009

Njoftim për bashkëpunëtorët

Të nderuar bashkëpunëtorë

Prej muajsh, redaksia ruan në arkivin për botim disa materiale, të cilat po të botohen zënë një hapësirë prej 2 ose më shumë faqesh.

Për këtë arsye, redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" njofton gjithë bashkëpunëtorë e saj, se shkrimet që sillen për t'u botuar, duhet të jenë jo më shumë se 5 faqe të daktilografuara (përafërsisht 10000 mijë karaktere, pa përfshirë hapësirat).

Materialet që vijnë me email ose në çdo lloj forme elektronike, duhet të jenë në **Word**, me fontin **Times New Roman**, të madhësisë **12pt** dhe me hapësirë **1.5**.

Gjithashtu, kujtojmë se materialet e pranuara në formë elektronike duhet të kenë patjetër germat **"ë"** dhe **"ç"**.

Çdo material i gjatë do ti nënshkrohet redaktimit dhe shkurtimit për tu botuar në versionin e shtypur të gazetës. Versioni i pa shkurtuar do të botohet çdo muaj në internet në adresën: www.rrugaearberit.com.

Autorët mund ti shkurtojnë vetë shkrimet dhe të na i përcjellin në redaksi me dy versione botimi: **për gazetë** dhe **për internet**.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira të redaksisë për bashkëpunimin e deritanishëm..

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën **<rrugaearberit@gmail.com>** ose në tel. **069 20 68 603.**

REDAKSIA.

Redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit", në bashkëpunim me një gazetë të përditshme shumë të njohur, kërkojnë një korrespondent për qytetin e Peshkopisë.
Të interesuarit të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

studime



Arkivat Turke dhe vlerat historike të kërkimeve

Nga: **Dr. SELMAN MEZIU**

Të zbulosh historikun e një populli në arkiva, më shqeto në këto magazina dokumentash është punë e vështirë e që kërkon vullnet, durim , pasion,njohuri të thellë të gjuhës e kohë të gjatë. Të pesëqind vjetët sundim politik, ekonomik, ushtarak të atdheut të arnautëve kokëfortë, ishte i vështirë e i mbushur me një dendësi ngjarjesh nga më makabret, sepse kërkohesh me këmmbëngulje kolonolizim fizik , shpirtëror e i trojeve stërgjyshore të tyre. E pikërisht duke operuar me kujdes në trupin e saj të stërmadh e gjymtyrë shumtë, *Profesor Ferit Duka*, kërkon që nëpermjet një dokumentazioni të pasur të hedh dritë mbi njërëz, data ngjarje e veprimtari ekonomiko shoqërore të krahinave të ndryshme Shqipëtare të përfshirë në Rumelinë Evropiane të ndarë në katër vilajete.

Libri i fundit ''*Shekujt Osman në hapsirën Shqiptare*,, me një seri artikujsh studimor e dokumentacion të marrë në arshivat e Stambollit etj, historiani F. Duka përpiqet ti ndriçojë nëpërmjet tyre e gjykimeve të tijë familjet bujare të shekullit të XV si atë të Kastriotëve e të Muzakëve, mbi qytetet e Vlorës, Beratit, Gjirokastrës e Himarës, mbi Hebrejt e shtrirjen e fesë Islame në shoqërinë e krishterë shqiptare të atyre kohërave.

Në trajtimin e familjes së *Kastriotëve* në artikullin prej gjashtëmbëdhjetë faqeve, studiuesi përpiqet ta shikoi në një, këdndvështrim shumëplanësh, duke analizuar marrdhënie ekonomike, politike, fetare, pronësie, të shtrirjes demografike etj, i mbështetur kryesisht te studiuesi *Halil Inalçik* e burime të tjera të njohura prej kohësh. Por në substancë nuk zbulon asgjë të re. Ai mbetet në hullinë e informacioneve, e trajtesave të problemeve të bashkëkohësve të tijë, si Selami Pulaha, Aleks Buda, Koço Bozhori, Hasan Ceka, Timo Dilo, Hasan Kaleshi, Kristo Frashëri, Kasem Biçoku etj.

Ndërkohë kur shumë probleme të familjes së Kastriotëve e mbi të gjitha mbi origjënën, veprimtarine politike, ushtarake te *Gjonit* e djalit të tije *Gjergjit* në trevën *Dibrane* e më gjërë mbeten të errëta, të diskutueshme, të pa dokumentuara. Edhe pse toponoimet, ononimet, vargjet e këngëve të rapsodëve rrëfimet gojore të ardhura bres pas brezi deri në shekullin tonë, janë të shumta, por këto në trajtesën e problemeve historike kanë vlera të skajshme. Ndërsa shoqerimi me dokumentacionin e asaj kohe e zbulimet arkeologjike në këto treva do të bënte sistemin shumëplanësh të dukurive historiko shoqërore, bindës e kthjellues të trajktoreve të ngjarjeve e qëndrimit të hirearkise ushtarake të të dy kampeve në luftrat gjithmone të ndezura.

Në gushtin e vitit 2007, me ndimën e historianit Moisi Murrja siguroi, një fotokopje të ''Tefterit turk të Dibrës të vitit 1467.,, i kopjuar në përkthimin e Vexhi Buharajit nga Historiani tjetër Dibrane Hilmi Sadiku. Në lexim e sipër mungonin faqet 13, 38, 30, dhe të dhënat për Gardhin e Poshtëm, Grishqanin, Muhurri e Shënvasilin. Paraqes kërkesën në Institutin e Historise për të hyrë në arkiv, dhe me dokumentin në dorë hyjë atje ku i paraqes kërkesen punonjëses së arkivit. Ajo pasi e lexoi më thotë: Të gjithë Tefteret jane ne dispozicion të *Historianit Ferit Duka* i cili po pregatit një libër. Në gjithë trupin ndjeva një shungullimë gëzimi që më pushtoi të tërin ndërkaq, më erdhi natyrshem mendimi:

Më së fundi Dibra do të ketë një libër me dokumentat e arshivave turke të përkthyera e studiuara deri më tani. Dhe më tej mendimi mori udhë: Atë që se bëri studiuesi Selami Pulaha në librin e tijë ''Lufta shqiptaro turke në shekullin e XV,, botuar në vitin 1968, Vexhi Buharaja e Dibranët Haki Sharofi dhe Ali Hoxha, me së fundi po e realizon një institucin shkencor. Sapo doli në librarit e Tiranës, nuk vonoi shume e ai fluturoi në Firence. Fillova ta lexoi e shfletoi me kërshëri, por nuk vonoi e më pushtoi gjithë qënien time një tajfun disfatist; durimi, dëshira, pasioni u dërmuan thermuan, mezi mbajta veten nga një dëshperim i pamatshëm. Edhe shekullin e XXI, historianët, etnografët, gjeografët,gazetarët studiues të kategorive të ndryshme Dibrane e më gjërë, e filluan mbrapsht, mbeten si lypsarët e skenave të dhimbshme Migjeniane. Por jo për bukë misri, por ushqim mendor,njohurish, për të t'iu dhënë dituri njerëzve që të njohin vetevetn, të kaluarën e mjergulluar.

Pyetjet që shtrohen janë këto?

Përse vallë zonat verilindore shikohen me syrin e njerkës edhe në këte fushë? A mos valle arshivat e Stambollit, në 350000 akte,ndër të cilat gjashtedhjetë e ca mijë janë para viteve 1225, dhe 600000 akte, ndodhen në Enderun-it (Top Capi) nuk shkruhet asgjë për këto krahina? A mund të besohet se e njëjta gjë ka ngjare edhe me te 376 kronistet e dinastisë së sulltanëve?

Nuk e besojmë as njërën edhe tjetrën, por pranojmë se në një gjëndje te keqe, të kalbura, të grisura, shumë dokumente të moçme janë bëre si brumë dhe si thëngjill, duke u kalbur karta e ngjitur mellani-thekson studiuesi Turk *Sheref Evrak,* në vitin 1910 .

Edhe kjo nuk e justifikon mungesën e të dhënave të popullsisë në afërsi të kalas së Gjonit; duke iu referuar historianit *Iliaz Kaca* i cili shkruan: ''Mospërmendja e tij (Kastriotit,S.M.)në rregjistrin kadastral (të vitit 1467, S.M) duhet shpejguar me mungesën e faqeve 55-57 të këtijë dokumenti.,, Ku duhet kërkuar mangësia, në heqjen me qëllim apo.....?

Nuk mbete gjë tjetër veçse të orientohemi, të bashkë punojmë për të gërvishtur ndryshkun e harresës apo djallëzitë cinike të ndonjërit e zbuluar reflektimin e diturise, duke ndriçuar skutat e errëta të historise në sundimin shumë shekullor osman, ndryshe ajo do të shtrembërohet e do të krenohen të tjerët me ngjarjet, heronjtë e vyrtytet tona. Ç'far fatkeqësie do të ndjente dituria? '' Dhe këte fatkeqësi e ndjejmë kaq më tepër – Shkruante me 1928, *Mid'hat Frashëri* - kur aspirojmë një jetë me përgjegjësi dhe dinjitet, kur fillojmë të ndjejmë se nevoitet të kemi dritë rreth nesh.,,

Nuk pretendojme nga ju *Profesor Duka*, të shkruani 25 volume për dokumentat në arshivet turke siç ka bëre Albonologu i madh *Zef Valentini* për ato të Venezies, as serbokroatit *Vikentij Vasiljevik Makuashev*, Gjermanit *Franc Bebinger*, Turkut *Mehmet Syreja*, Polakut *Jan Gregor Zeuski*, Grekut *C.N. Seathas*, por të paktën ngjituni në botimet e Historianit *Injaz Zamputa*. Ndoshta përkthimi i shënimeve të udhëtimit të studiuesit turk *Elvija Tschelebi (1611-1683)* në librin ''*Sejabatmam*,, apo të qeveritarëve turq në trevat e sipërpermendura do të ishin nje ndihmesë e përsosur në ndriçimin e të panjohurave të asaj periudhe.

Ndërsa studiuesi *Ali Hoxha* do të ishte një tjetër kërkues i rëndësishëm për këte periudhë, artikujt e tijë si ''*Defteri emror i vilajetit të Dibrës i vitit 1467dhe disa mendime rreth vlerës së tijë historike.,, (1985)*

Gjetja e burimeve financiare, do ta futnin atë në hullinë e kërkimeve, të tefterëve e burimeve të tjetra të kësaj perandorie,e më pas duke i përmbledhur në një libër i cili i shoqëruar me një hartë gjeografike të vendbanimeve të atëhershme e të sotme, sepse vetëm në këtë mënyrë do të saktësohesh më mirë e korrektë vendëndodhja i tyre e të gjitha këto do të ishin një ndihmesë e madhe për kërkuesit e historisë se verilindjes se shqipëris.

Një rëndesi të pallogaritshme, do të ishte përkthimi i librit *Hadikat-ul-Vuzera* (Kopshti i Vezirëve),i cili vendos në pah se nga 172 vezir të mëdhenj , 18 janë Shqiptar, duke përmbledhur një periudh që nga formimi i Turqisë e deri te Selim III, e më tej një numër i madh pashash dytësor, komandant të niveleve të ndryshme, qeveritarë lokal, piktor, arkitekt, muzikantë etj. Shkresat, urdherat e tyre me shkrim, letrat ne shkëmbime private e më gjërë, takimet diplomatike, jeta et yre private, e në hirarkine otomane, do të ishin copëza të jetës e veprimtars*ë së gjallë historike, vetëm kështu do të largonim, pyllin e pafund të pikpyetjeve që rrethon histohrigrafinë tonë.*

Ndërsa profesor *Ernest Koliçi* e shikon këtë plazmim nga formimimi i karakterit në kushtet historiko gjeografike vazhdimisht në ndryshim e vyrtytet e kristalizuara ndër shekuj të Shqiptrëve dhe ja si shkruan ai më 1964 : '' *Në Perandorin ushtarake turke të privilegjuar apo klasa shoqërore: kush merrte pjesë me detyrim ose vullnetarish në ishtri, e që dalloheshin për zotësinë e tyre apo për përshtatshmëri ose efektivitet, mund të ngjitej në shkallët hirarqike perandoreke.Kështu shume Shqiptar, të cilët ishin njohës të përsosur të armëve edashuronin artin e luftës e me guxim të veçntë,preferoheshin shumë shpejt në Turqinë e atëhershme si komandanta lufte.Pushtuesit e Persisë, të Arabisë e të tjerë komandantë të ushtrisë osamane ishin me origjinë Shqiptare.Nga të ngarkuarit ne fushën ushtarake e ne fushën civile më pas kalonin shpejt. Shqiptar të Turisë pothuajse njëzet ishin nga Vezir të mëdhenj e deri kryetar Qeverishë,,*

Lind natyrshëm pyetja: A kemi të shkruara copëza biografike të të gjithë këtijë ansambli njerëzish të shquar në jetën politike, ushtarake, shoqërore e kulturore të perandorise gjigande turke? Cilët janë poetët, shkrimtarët historianët me origjin shqipëtare, apo emigrantë që po lërojnë ne zbulimin e copëzave të errëta të bashkëatdhetarëve të tyre?

Në perëndim dihet shumë pak. Në bibliotekat e Parisit, Londrës, Madridit, Brukselit, Berlinit, Romës etj gjënden pak libra e informacione të shkruara. Përse vallë kjo varfëri, në fushën e diturisë, e të shkruarit, të historisë e kulturës e etnografisë, të shqiptarëve? Si shpejgohet kjo dukuri? Cilat janë shkaqet, rrënjët e saj ku duhen kërkuar,në shoqërinë kulturore e politike turke apo nga psikologjia e kultura e shqiptarëve të shtegtuar atje përgjatë rrokullimës së qindravjeçarëve?

Nuk mund t'ia ngarkojmë këte ndërmarrje gjiganteske vetëm një profesori apo historishkruesi, do të ishte donkishotizëm, por pikëza pikëza duhet të kontribujnë inteligjenza me origjine shqiptare e cila bashkëjeton me popullin turk në Stamboll, Izmir, Bursa, Edirne, Ankara ,studentët e punonjësit ee ambasadorët shqiptar në Stamboll e Abkara etj. Megjithëse *Osmanishtia e vjetër* nuk mësohet më, pas Revolucionit të Qemal Ataturkut e reformat e tijë në të shkruarin e gjuhës turke. Si përfundim kërkohet mësim individual apo i veçantë, i specializuar. Por kjo nuk duhet të bëhet barrier e pakalueshme.

Të gjithë shkruesit e gjedheve të ndryshme presin nga ju profesor Ferit Duka botimin e serive të tjera me dokumenta të përkthyera nga arshivat e sipërpërmendura, e shpresojm që nuk do të ndodh si me nëntë seritë e vëllimeve mbi historinë e shekulit të XV te Profesor Kristo Frashërit i cili nga botimi i të parit në vitin 2005 ende s'po duken në horizontet ylberike të kultures së historigrafisë shqiptare volume të tjera.

Ndërkohë kur shumë probleme të familjes së Kastriotëve e mbi të gjitha mbi origjënën, veprimtarine politike, ushtarake te Gjonit e djalit të tije Gjergjit në trevën Dibrane e më gjërë mbeten të errëta, të diskutueshme, të pa dokumentuara. Edhe pse toponoimet, ononimet, vargjet e këngëve të rapsodëve rrëfimet gojore të ardhura bres pas brezi deri në shekullin tonë, janë të shumta, por këto në trajtesën e problemeve historike kanë vlera të skajshme. Ndërsa shoqerimi me dokumentacionin e asaj kohe e zbulimet arkeologjike në këto treva do të bënte sistemin shumëplanësh të dukurive historiko shoqërore, bindës e kthjellues të trajktoreve të ngjarjeve e qëndrimit të hirearkise ushtarake të të dy kampeve në luftrat gjithmone të ndezura.

vlerësime

SHTEPI E BESËS, BUKËS, PENËS DHE E PUSHKËS

Fisi Gjoka në Macukull të Matit i njohur jo vetëm në Mat e në Dibër, por dhe me gjerë.

Nga: **YMER KETA.**



Macukulli një fshat i ndërtuar rrëzë Malit të Dejës, ku po të ngjitesh në kodrën ku ishin të ndërtuara shtëpitë e fisit Kola, shikon po thuajse të gjitha fshatrat e Matit. Edhe pse në kushte të vështira ekonomike, kush ka patur rastin të kaloje e të bujë në ketë fshat si udhetar, studiues apo luftëtar ka ngelur i habitur me ato zakone e tipare fisnike të këtyre njerzve.

I ndjeri Qamil Xhika, Doktor i Shkencave Bujqësore, recitonte me mall për fshatin e tij të lindjes, duke i berë këngë, e cila këndohet dhe sot nga rapsodët, në oda apo në festivalet folklorike.

O fshati im i bukur,
Emrin ti, e ke Macukull.
I ndërtuar rrëzë Dejës,
Ke qenë vend i Betejës.!

Macukulli është i njohur në histori, ku shumë luftëtar nga ky fshat, u dalluan për trimëritë e tyre në luftërat kundër turkut, serbit dhe Austriakut. Ndër to dhe fisi Gjoka.Ky fshat ka patur mbi 900 shtëpi, me 8 lagje, ku veçojmë lagjen Gjoka me fiset Gjoka, Leka,Beqiri, Kryekurti, Milloshi dhe Doçi.

Puna ime e deshti që të punoj në disa rrethe të Shqipërisë.Gjithashtu të njihem e të bashkëpunoj me persona të shumtë. Ishte vitit 1976, për here parë shkelja në këtë fshat Malor, me tradita të shkëlqyera. Aty ku prodhimi i drithërave ishte i pakët, kështu që banoret e këtij fshati historikisht e kishin blerë bukën në Fushën e Mates, në Pazarin e Dibrës, të Lezhës dhe të Prizrenit. Pra ashtu si dhe barutin blenin dhe bukën. Bujaria e fiseve në ketë fshat ishte dhe është për tu admiruar. Ata e blenin bukën me lek dhe e jepnin pa lek. Ngelej në kujtesë të gjithë atyre personave, që kanë patur rastin të kalojnë e të bujne në këtë fshat, ku kanë marrë me vete bujarinë e njohur në të gjithë Matin. Rastësia bëri që të njihem me Sali Gjokën. Një burrë i urtë, punëtor, i mençur e hokatar. Ai fliste pak. Nuk të drejtonte tek tjetër kush, por në shtëpinë e tij. Një shtëpi përdhese, por e pastër e gjithë bardhësi. Aty gjeje njerëz me zemër të madhe. E shoqia e Saliut një grua e fisshme, (Mihanja) të takonte me përzemërsi. Para se te sillte kafen, të pyeste nëse ke ngwnw bukë. Ajo ta dinte hallin pasi kishte dhe fëmijët e saj që punonin në ushtri e në sektor të tjerë.Ajo ishte mësuar të priste e të përcillte miq. Të përgatiste fëmijët në shkolla, e pasi i mbaronin ato, i vinin me nipa e mbesa, ku gumëzhinte shtëpia, por oda e miqve rrinte e hapur. Miqtë e kësaj shtëpie, tashmë nuk ishin vetëm nga Mati, por nga Tirana e Vlora. Ngeleshe i habitur, kur mësoje se djali i Saliut Dalipi, shërbente si mjek në ketë fshat së bashku me bashkwshorten, Engjellushen. Por ata vinin në shtëpi në oret e vona pasi shkonin lagje në lagje e shtëpi në shtëpi, duke i shërbyer komunitetit.

Para se të hyja në këtë shtëpi, u njoha me jetën dhe veprën e Rexhep Haxhiut (Gjokës).

Më ka ngelur në kujtesë jeta dhe vepra e këtij atdhetari e patrioti, i cili kishte marrë pjesë me armë në dorë në betejën e "Shkallës së Deshve".

Edhe me pushtimin e vendit nga nazifashizmi, fisi Gjoka ishte një bazë e LANC. I pari i fisit Gjoka Rexhepi u zgjodh Kryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar. Djali i tij Ramadani, hodhi armët në sup dhe u radhit përkrah çlirimtarve në çetën heroike të Pezës, deri në çlirimin e plotë të vendit. Ndërsa Saliu u aktivizua në komandën e vendit.

Djali tjetër Kurti u aktivizua si korrier i luftës, duke dërguar informacione e mesazhe nga njëri njësit në tjetrin.

Mbas çlirimit të vendit banorë e këtij fisi, morën pjesë aktive në ndërtimin e vendit të sapo dalë nga lufta.

Në fushën e Arsimit kanë punuar e dhënë kontribut, Shahini, Haliti, Nazifi, Rasimi, Behari dhe Shkelzeni. Në sektorin e Shendetsisë, Dalipi së bashku me bashkëshorten Engjëllushen kanë dhenë një kontribut të çmuar si mjek, ku këtë kontribut e japin dhe aktualisht. Në sektor të bujqësisë kanë dhenë kontributin e tyre dhe Haxhiu me Halitin, ku ky i fundit, si Agronom apo përgjegjës sektori i profilizuar e i arsimuar, ka dhënë mesim dhe në shkollën e mesme bujqësore për disa kohë. Haxhiu ka drejtuar sektor të rendësishëm të ekonomisë.

Një kontribut të çmuar kanë dhenë në fushën e letrave si Rasimi dhe Behari, ku ky i fundit, është bërë një studiues i i thellë i letërsisë shqipe dhe lëvrues modern i prozës, duke sjellë në letërsinë bashkkohore shqiptare një zë të veçantë dhe orgjinal, duke përmbledhur disa nga romanet e tij si " Shitësi i Gurëve të varrit", " Orët e ringjalljes" dhe " Mashtrim i bukur". Proza e tij dallohet për orgjinalitetin, tematikën interesante, mënyrën e përshfaqies së saj. Ai të befason me impulsitetin, stilin e mprehtë, dialogun e zhdërvjelltë, rrëfimin me nota të qarta poetike. Gjetja dhe mënyra e përdorimit të këtyre fjalëve e shprehjeve,duket qartë se nuk është qëllim në vetvete ; ato e lëmojnë frazën, e zbukurojnë shprehjen, e impulsojnë rrëfimin, duke i diferencuar artistikisht ngjarjet dhe personazhet.

Shpresojmë që të tjerë djem e vajza të këtij fisi, të ngjiten në kete skenë, për të venë nga një gur në ketë kala diturie.

FAMILJA FRANGRU NË LIS TË MATIT

Nga: **MEVLUD BUCI**

Nëse njeh apo nis e mëson për traditat e matjanëve, për gjurmët e tyre në histori, ndjen krenarinë legjitime sesi çdo familje e kësaj treve ka plot gjurmë nëpër kohëra.Brez pas brezi e djalë pas djali vijnë deri në ditët tona qëndresa, fisnikëria, urtësia e shpirtit demokratik popullor.Kështu ndodh dhe me familjen Frangu në Lis të Matit.Vërtet janë matur e peshuar si i thonë fjalës, sepse bëmat, të vërtetat, gjurmët e fisnikërisë, gurgullojnë nëpër kohëra.Në Lis e më gjerë mëson nga afër për traditat e breznive të familjes Frangu.U befasuam dhe u gëzuam thellësisht në shpirt kur kohët e fundit morëm rastësisht në duar librin e studiuesit të talenntuar matjanë Ramiz Fiçori :"Mati dhe matjanët, në rjedhën e historisë" ku në faqen 87 flet për të parin e familjes Frangu Dhimitër Frangu(1443-1525). Dhimitër Frangu, shkruan studiuesi Ramiz Fiçori, është një personalitet i rëndësishëm historik, jo vetëm se ishte ndihmës i Skënderbeut por se ky shkroi një libër për Skënderbeun, më 1480 nga ku bazohemi edhe ne sot. Dhimitër Frangu ishte me origjinë nga veriu, ku mbiemri Franki apo Frangu e kemi dëshmuar që nga mezi i shekullit XV(Martin Franki në Lis të Matit).Nga fisi i njohur Frangu ka mjaft figura që bënë emër në historinë kombëtare.Dhe ato janë shumë se nga kjo familje kanë dalë shumë figura patriotike e atdhetare.Nuk mjafton një shkrim i vetëm të trajtohen të gjitha. Nurë Hasan Frangu lindi më 25 nëntor 1917 në Lis të Matit dhe vdiq në Tiranë në vitin 2004.Në Lis, Vinjollë, Qafë Murrë e Lukan nëpër oda të thonë ende sot : "Ka thënë Nurë Frangu. E sot si testament Nurë Frangu, pinjoll i kësaj kulle të njohur ka lënë urtësinë, bujarinë, thjeshtësinë dhe nderimin popullor.Por jo vetëm Nura, por dhe vëllai i tij Tofiku ishte njëri ndër ato burra të shquar të kësaj kulle.Dhe kudo ku punoi Tofiku la emër të mirë si në Tiranë, Korçë,Peshkopi, Mat, Zerqan, Shkodër.Tofiku gëzonte respektin e të gjithëve se këtë repsekt ua impononte të tjerëve me sjellje dhe vyrtyte të mira që e karakterizonin. Djali i Tofikut, arsimtari dhe intelektuali i kompletuar Kujtim Frangu u vra në vitin 1997 në qendrën e votimit, vrasje e cila bëri bujë jo vetëm në Mat por në të gjithë vendin tonë atëherë.Dhe pikërisht më datën 6 korrik 2010 në një nga sallat e muzeut kombëtar u përkujtua përvjetori i vrasjes së këtij martiri të demokracisë ku morën pjesë dhe deputet të Qarkut Dibër si Selami Xhepa, Bedri Hoxha, Sherefedin Shehu e mjaft figura të tjera të njohura të politikës dhe pushtetit.Sot në kujtim të tij një rrugë në Lis të Matit mban emrin "Kutim Frangu".Kalvari i luftës së klasave, hija e zezë e biografive e ndoqi familjen e nderuar Frangu, por fëmijët, nipërit dhe mbesat që lindeshin e rriteshin në këtë kullë me emër, u rritën dhe edukuan me traditat e vyera të kullës së Frangut, me kulturën e gjyshërve dhe etërve të mençur, puntorë e bujarë.Hasan Frangu, njëri nga shtatë fëmijët e kullës së Frangut ka 40 vite që shërben me përkushtim në arsim bashkë me gruan si në fshatra të ndryshëm të Matit e tani në shkollën Mëzes të Tiranës dhe puna e tij prej edukatori flet vetë për arritje në këtë periudhë kohore mjaft të gjatë. Për familjen Frangu flasin shumë veta sot, familje që nderohet kudo pasi kjo familje ka rrezatuar vitalitet brezash ndër vite.

HOMAZH

Besnik Karaj jeton midis nesh

Besnik Karaj lindi në vitin 1959 në fshatin Kocaj-Bulqizë në një familje të mençur, trime dhe patriote. Gjyshi i tij kryeplak dhe njeri i mençur.

I ati Mustafa Karaj ish-kuadër oficer dhe më vonë nëpunës në minierën e Bulqizës. Ai është punëtor dhe i palodhur në punën e tij kudo që ka punuar.

Besniku mbaroi shkollën 7-vjeçare në vendlindje me nota të mira. Në moshën 14-vjeçare shkon në shkollën "Skënderbej" dhe pas 4 vjetësh në shkollën e bashkuar të oficerëve në Tiranë ku disiplina dhe mësimet e tij kanë qenë shembullore.



Në vitin 1979 doli oficer me gradën e nëntogerit ku punoi në korpusin e Burrelit, ku puna e tij u vlerësua gjatë gjithë kohës. Më vonë kaloi në detyra më të larta si shef i degës ushtarake të qytetit të Burrelit dhe me policinë ushtarake të këtij rrethi.

Në vitin 2002 kaloi me policinë ushtarake të Tiranës dhe me policinë e rrethit të Durrësit. Puna e tij kudo që punoi u vlerësua dhe mori gradën Nënkolonel. Ai ishte kuadër me shumë vullnet dhe i papërtuar në detyrën e tij kudo që ka punuar. Ai ishte i mençur, i palodhur dhe besnik i zbatimit të detyrave, rregulloreve dhe ligjeve që kishin të bënin me detyrën e tij. Ai përkrahu reformat demokratike gjatë gjithë periudhës së tranzicionit.

Besniku ishte shumë i dashur dhe shumë i lidhur me familjen, të afërmit dhe gjakun e tij. Ai kishte shumë shokë e miq. Në vitin 1992 u martua me një vajzë shumë të mirë me profesionin e farmacistes. Ai e njihte mirë ekonominë e tregut, e shoqja u ingranua me biznesin privat të farmacisë, ku puna e saj ishte lavdëruese.

Në vitin 2003 u vendos në qytetin e Durrësit familjarisht por ja, jashtë parashikimeve të të gjithëve, në një moshë të re, ku mund të jepte më shumë si në familje dhe në punë të shtetit, ai u nda nga ne në mënyrë të papritur nga një aksident automobilistik tek ura "Skuraj"...!

Kanë kaluar 5 vjet nga ajo ditë e zezë që Besnik Karaj ai burrë gjigant e me zemër të madhe u përcoll nga qindra shokë e miq për në banesën e fundit!

Familja e tij, vajzat, djali, i ati, e ëma dhe ne shokët dhe farefisi i tij na duket sikur është i gjallë.

Ai do të jetojë gjithmonë midis nesh

AQIF KARAJ

Floriana Borova po mahnit Amerikën me talentin e saj. Ajo është zgjedhur e 13-ta, basketbolliste që shënon mbi 1000 pikë



Floriana Borova, fituese e trofeut "Topit i Artë"



Nga: **BEQIR SINA**, New York,

Përveç futbollit, për të cilën kemi shkruar edhe më parë për Floriana Borovën, ajo tashmë kanë bërë famë në edhe në moshat e reja në Basketboll, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Madje, ajo ka bërë edhe histori duke qënë se është futur në listën e 13-ta, basketbolliste, që gjatë karjerës së saj për të reja shënon mbi "Një mijë Pikë" për femra.

Floriana Borova, është njëra ndër ato talente shqiptare në Amerikë, që ka arritur suksese. Kur ajo ishte 16 vjet, në katër kampionate të futbollit për grupmoshat e reja në SHBA, ishte shpallur golashënuesja më e mirë, falë golave, të cilat i pati realizuar me fanellën e klubit Cresskill Cougars nga New Jersey.

Me këtë rast, Floriana Borova shpeshherë përmendej edhe nga zyrtarët e Federatës Amerikane të Futbollit, të cilët thonë se 16-vjeçarja është një talente e rrallë, dhe e cila premton shumë për të ardhmen. Andaj, me të drejtë edhe mediat amerikane, e veçmas ato lokale të New Jerseyt, shpeshherë fokusohen te Borova, duke botuar artikuj te ndryshme rreth saj, etj.

Borova, e cila ka lindur në Amerikë, por që ka prejardhje nga Dibra e Madhe, është nxënëse e shkollës së mesme Cresskill të New Jerseyt, dhe vitin e ardhëshëm do të luaj basketboll për femra me William Paterson University", me një burës falas si rezultat i suksesit të saj në sport.

Sipas www. northjerseysports.com, skuadra Cresskill Cougars, e cila viteve të fundit qëndron vazhdimisht në vendin e parë në tabelë në garat e New Jersey, pranon se është krenare që në gjirin e saj e ka pasur, deri dje talenten Floriana Borova.

Në jetën tënde ndoshta nuk ka kuptim më të madh të lumturisë, pastaj arritjes së suksesit, ndërkohë që familja, miqtë dhe të dashurit nga ana tjetër me të njëjtat emocione dhe me të njëjtën dashuri, janë për të ndarë atë gëzim suksesi, edhe me ty. Për disa, kjo mbetet një ëndërr e largët, por për studenten -sportiste e suksesshme shqiptare në SHBA-ës, vajzën dibrane Floriana Borova, ajo që ishte ëndërr deri dje, u bë një realitet, sot kur ajo përfudnoj shkollën e mesme.

Ajo u bë realitet, teksa u mybll edhe viti shkollor ku Floriana Borova, e mbylli atë me plot sukses , në mësime dhe sport. Por, edhe përpara se ylli fundit i ekipit të vajzave të skuadrës së basketbollit për të reja Cresskill, shënoi në librin e historisë, edhe lojtaren e 13-të, për basketbollin e femrave në historinë e shkollës, që ka arritur një moment historik. Me shënimin e 1000-pikëve në karrierën e saj gjatë këtyre viteve sa luajti me skuadrën e të rejave në basketboll, Cresskil Courage , Borova u bë basketbollistja më e mirë e këtij viti duke marrë edhe medaljen e artë me një vlerë 2.000 dollarë.

"Kjo është një ndjenjë të mahnitshme," tha Borova, pas marrjes së çmimit "Basketbollistja më e mirë "për të rejat në Nju Xhersi. "Dua të falënderoj familjen time, gjyshin tim, i cili më qëndron shumë afër dhe më inkurajon tha ajo, shoqet e mia të shkollës dhe të skuadrës, trainerët, sepse pa ata të gjithë dhe mbështetjen e tyre, kjo nuk do të kishte qenë e mundur."

Borova, u bë një anëtare zyrtare e klubit të Cresskill-it, me 1000-pikë, dhe fiton të drejtën e studimit për në çdo kollegj amerikan - pa pagesë. Kjo është për Floriana Borovën, "sfida e re e radhës, e cila tashmë është gati, dhe e pret atë në Universitetin William Paterson."

"Unë jam e prirur të ngulmojë drejt suksesit, dhe këtë do t'a kërkojë kudo edhe duke luajtur basketboll në William Paterson University," tha Borova . "Por, unë dua të punojë edhe më shumë, të arrijë një gjë të tillë që pasi e di që do të duhet të më marrë disa kohë, sapo të "njihem e miqsohem " mirë me shoqet e tjera të skuadrës së re të Universitetit William Paterson."

Gazetat sportive të Nju Xhersit, shkruajn se :"Një gjë është e sigurt: pa marrë parasysh se çfarë Borova zgjedh të bëjë, ajo do të ketë mjaft njerëz atje për mbështetjen e saj, duke besuar tek talenti i saj që jep premisa të mëdha suksesi në të ardhmen e saj" kanë thënë specialistët, të cilët e njohin mirë lojtaren dibrane Floriana Borova.

Në mbyllje të sesionit 2009-2010, Borova me fanelën me numërin 15-të, mbajtëse e shiriti të kapitenes së skuadrës, në ndeshjen e fundit të kampionattit të rejave në Nju Xhersi, ajo shënojë një të katërtat e pikëve në një fitore 44-20 të skuadrës së saj Cresskill mbi Dwight-Englewood. Flo, arriti në shifrën 1126 pikëve, në katër sesione për të rejat në Nju Xhersi, dhe fitoi çmimin "Topi i Artë"

E pyetur nëse ajo ishte "më kërkuese" ditur se çfarë mund të thotë për të shënuesia më mirë me mbi 1000 pikë, dhe fituesia e trofeut "Topit të Artë", ajo u përgjigj, "Jo unë nuk do të thosha se kam arritur gjithëçka, "jamë më shumë e etur" sepse, unë vetë jam e ngazëllyer për të parë veten të marrë çmimin "Një mijë Pikë", dhe e kam kërkuar që këtë t'a arrijë përmes punës - lojës për ta bërë."

Mbas këti suksesi Floriana Borova, mori urimet më të ngrohta natyrisht si fillim nga familja dhe miqtë e saj, të cilët morën pjesë në ceremonin e organizuar për të përgëzuar atë, në arritjet e saj. "Flo, është një lojtare e madhe basketbollit, për moshën e saj" tha vëllaii madh i saj Artani, i cili luajti vetë basketboll për trajnerin legjendar Martit Kugar Rivard, gjatë viteve të shkollës së mesme.

"E mbështetur vazhdimisht nga vëllai i saj më i madh, mendoj se është pikërisht lloji i shpirtit konkurruese i cili dallohet tek Borova," tha Drejtori i Klubit të Atletikës Cresskill, Beth Del Vecchio, duke shtuar se unë pashë qysh në fillim një Floriana e re, kur ajo mësoi si të bëhet një yll, dhe nisi të lulëzojë në arsimin e klasës së parë fizike."

"Edhe atëherë mund të them se ajo ishte në gjendje dhe premtonte se do të bëhej shumë shpejt një sportiste e veçantë," tha Del Vecchio, i cili, gjatë ceremonisë së përfundimit të sesionit sportiv dhe mbylljes së shkollës, për këtë maturë, i dhurojë vetë Borovës një buqet me lule të freskëta dhe një top basketbolli përkujtimor .

Drejtori i Klubit të Atletikës Cresskil, Beth Del Vecchio, thotë se Borova, është spotiste e rrallë që mund "të bëjë të gjitha", pa asnjë një rezervë. "Floriana Borova, në skuadrën Cresskill, është gjithashtu një sulmuese e "rrezikëshme" në fushën e futbollit dhe është një lojtare diamant, në softball. Ajo është shumë e aftë për të luajtur të tre sportet në nivel të duhur studentor, kështu që nuk është për çudi që kjo do të jetë, edhe një "yll" edhe në Universitet".

Floriana Borova ka një vëlla 21 vjeç me emrin Artan. Po ashtu, ajo ka edhe dy motra, Diana 19 vjeçe dhe Enisa 9 vjeçe. Floriana Borova me dëshirë gjithmonë tregon se ka prejardhje shqiptare, ndonëse ka lindur në Amerikë. Gjyshi i saj Sylejmani një emër i njohur i këngës popullore, në ato vite në Kosovë dhe Dibër të Madhe, dhe babai i saj, Muharremi, kanë emigruar në Amerikë nga Dibra e Madhe , dekada më parë dhe jetojnë së bashku në Nju Xhersi.

www.rrugaearberit.com
online
Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.



Email: info@devadesign.net. *Phone:* 612 203 5960. www.devadesign.net

cyan magenta yellow black